



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

**01. Nr.**  
**Kaçanik ;15.10.2010**

## **RAPORTI I EKZEKUTIVIT PËR PERIUDHËN JANAR – SHTATOR 2010**

**K a ç a n i k ; T e t o r 2 0 1 0 .**

---

**Zyra e Kryetarit**

## Vështrim Hyrës

Ekzekutivi i Komunës ka filluar aktivitetin e vet me synim të përmbushjes së të gjitha objektivave të prezantuara në programin e vet të punës , harmonishëm me Statutin e Komunës së Kaçanikut, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregulloret e punës. Ekzekutivi i Komunës në organizimin e vet ka këta sektorë, përkatësisht drejtori komunale:

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike dhe
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

Aktivitetet kyçe të Ekzekutivit të Komunës edhe gjatë kësaj periudhe nëntëmuajore ishin:

Koordinimi i punëve me drejtorët e drejtorive

Shtimi i efikasitetit dhe cilësisë në punë

Ushtrimi i përgjegjësive dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës dhe në pajtueshmëri me Statutin dhe Rregulloret e punës

Ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

Koordinimi i aktiviteteve me donatorë të brendshëm dhe të jashtëm

Përcjellja e realizimit të projekteve

Plotësimin e të gjitha nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve

Bashkëpunimi ndër komunal

Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës

Bashkëpunimi me Organizatat ndërkombëtare

Shënimi i përvjetorëve të betejave dhe rënies së dëshmorëve, ditës së Çlirimit të

Komunës dhe Përvjetorit të dytë të Pavarësisë etj.

► Në kuadër të Ekzekutivit të komunës kanë vepruar edhe, Zyra e Informimit, Zyra e Personelit, Zyra e Prokurimit, Zyra për Teknologji Informative, Njësia e Auditorit të Brendshëm etj. ndërkaq nën udhëheqjen e kryetarit të komunës ka funksionuar edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

### ■ Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Në fillimit të vitit, siç është e paraparë edhe me Udhëzim administrativ është hartua dhe miratuar Plani i Veprimit i këtij Këshilli, ku përveç objektivave dhe projekteve më me prioritet është caktuar edhe orari i takimeve për këtë vit. Sipas akteve normative, ky Këshill gjatë një viti duhet të mbajë së paku 10 takime. Gjatë kësaj periudhe nëntë muajore janë mbajtur 8 takime, dhe deri në fund të vitit do të përmbushen objektivat e këtij plani për mbajtjen e takimeve. Edhe pse KKSJ-ja, është organ këshill dhënës dhe rekomandues, gjatë këtij viti ka pas për objektiv dhe ka trajtuar këto tema:

- Përmbushja e të gjitha obligimeve legjislativë që rrjedhin nga dispozitat ligjore të nivelit qendror dhe atij lokal, për KKSJ-te,

- Trajtimi dhe adresimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve, në kohë të duhur dhe vend të duhur,
- Luftimi i dukurive negative përmes projekteve konkrete,
- KKSB-ja, si trup konsultues, të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve, përmes projekteve të ndryshme, ja ka adresuar qeverise komunale për miratim dhe për mbështetje financiare.

Me rekomandimet e këtij këshilli, përmes disa projekteve janë ndërmarr disa masa adekuate parandaluese për sigurinë e qytetareve të komunës tonë.

### ■ Zyra për Informim

Zyra për Informim, ka filluar aktivitetin e vet me synim të përmbushjes së të gjitha objektivave të parashtruara në planin e punës, të hartuar për vitin 2010, konform detyrave dhe përgjegjësi të parapara për vendin e punës.

Zyra për Informim, prioritet të saj ka informimin e rregullt, të drejt dhe efikas. Zyra për Informim në vazhdimësi ka prezantua punën e të gjitha organeve të pushtetit lokal, duke kultivuar transparencë në këto organe. Publiku po ashtu përmes faqes zyrtare është informuar për punën dhe aktivitetet e institucioneve tjera që i menaxhon pushteti lokal, për ngjarjet dhe zhvillimet tjera që ndodhin në komunë apo që kanë të bëjnë me komunën.

Zyra për Informim, për të krijuar transparencë më të madhe dhe me qëllim të informimit, mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik në nivel lokal dhe qendror, njoftimin e tyre për të gjitha takimet, ngjarjet, zhvillimet dhe manifestimet që mbahen në komunë.

Sikurse në çdo fillim viti, ashtu edhe në fillim të vitit 2010, është organizuar konferencë me gazetarë, ku kreu i komunës, z. Xhabir Zharku, vitin 2009 e ka cilësua si vit arritjesh të qeverisë komunale ndërsa gazetarët i ka vlerësua për raportim korrekt.

Me qëllim të krijimit të një imazhi sa më pozitiv për komunën dhe me qëllim të publikimit të punës dhe aktivitetet e komunës si dhe me qëllim të rritjes së transparencës, në fillim të muajit Janar 2010 është publikua vëllimi i dytë i Vjetarit 2009 për periudhën Korrik – Dhjetor.

Zyra për Informim ka publikua njoftimet për të gjitha aktivitetet, mbledhjet e Komiteteve, mbledhjeve të Kuvendit të Komunës si dhe të organeve tjera të komunës. Zyra për Informim, në vazhdimësi ka përcjell të gjitha takimet e ekzekutivit të komunës, e sidomos takimet e rregullta të fillim javës dhe fund javës të cilat edhe janë publikuar në Faqen zyrtare të komunës për të bërë sa më transparentë punën e Ekzekutivit të Komunës dhe njëkohësisht duke i ofruar publikut informacione qenësore nga këto takime.

Gjithashtu në vazhdimësi janë përcjell takimet e Komiteteve e në veçanti takimet e Komitetit për Politikë e Financa. Informatat nga këto takime, gjithë herë brenda ditës, janë publikuar ne Faqen zyrtare, ashtu sikurse edhe informatat nga takimet e Kuvendit të komunës dhe çdo herë janë ilustruar me foto. Po ashtu janë përcjell të gjitha takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ndërkaq temat e trajtuara i janë prezantuar publikut përmes Faqes zyrtare të komunës.

Zyra për Informim, po ashtu ka përcjell të gjitha takimet e kryetarit të komunës, ndërsa publiku është njoftuar rregullisht me temat dhe çështjet e trajtuara.

Zyra për Informim ka përcjell dhe publikuar të gjitha Manifestimet Përkujtimore në përvjetorin e rënies së dëshmorëve dhe betejave të zhvilluara në komunën tonë të cilat janë organizuar nën përkujdesen e kryetarit të komunës.

### ■ Zyra e Personelit

Gjatë periudhës raportuese ju njoftojë se përmes Zyrës së personelit janë kryer të gjitha punët administrative që kanë të bëjnë me zhvillimin e 12 procedurave të menaxhimit të personelit sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi shërbimin civil komunal. Sipas udhëzimit administrativ që ka të bëjë për procedurën e rekrutimit nga zyra e personelit janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit për vendet e punës të shpallura publike.

Për shpalljen e të gjitha këtyre vendeve të lira të punës, kemi kryer të gjitha punët e nevojshme administrative dhe menaxhuese duke filluar prej hartimit të vendimeve për emërimin e komisionit rekrutues, vendimin përfundimtar dhe kontrata mbi marrëdhënien e punës.

Kemi bërë përpilimin e vendimeve për udhëtime zyrtare, përgatitjen e vendimeve për ndërprerje të marrëdhënies së punës së shërbyesve civil komunal sipas kërkesës tyre, pastaj janë zhvilluar edhe procedura disiplinore për të cilat janë marrë masa disiplinore. Ndërsa në komisionin e ankesave janë përcjell gjashtë ankesa për të cilat është zhvilluar procedura.

Për dy ankesat e paraqitura në Këshillin e pavarur mbikëqyrës të Kosovës, kundër vendimeve të komisionit komunal të ankesave, kemi përgatitur përgjigjen në ankesat dhe kompletimin e fakteve dhe argumenteve për rastet konkrete,

Lëshimi i vendimeve për pushime vjetore, të veçanta, të lindjes dhe pushime pa pagesë si dhe evidentimi dhe ruajtja e tyre në mënyrë elektronike dhe në dosje personale për tërë personelin administrativ.

Përpilimi i kontratave të reja për punëtorët e sistemuar në vende të reja pune dhe vazhdimi i kontratave të skaduar të shërbyesve civil komunal.

Mbajtja e evidencës së të gjithë punëtorëve të SHCK-ës dhe rifreskimi i tyre duke pasur parasysh të dhënat e tyre personale, kualifikimin, titullin e pozitës, datën e fillimit, pagën etj. Numri i përgjithshëm i shërbyesve civil komunal duke pasur parasysh edhe punëtorët e qendrës për punë sociale, zjarrfikësit dhe sektorin e pylltarisë ka arritur në 126 punëtorë ndërsa, 10 numërohen nga stafi politik d.m.th. gjithsej 136.

Janë hartuar të gjitha vendimet e marruara nga Kryetari i Komunës që kanë të bëjnë me çështjet e personelit.

Nga zyra e personelit janë përgatitur raporte tre mujore për Ministrinë e Administratës Publike dhe lidhur me numrin e përgjithshëm të personelit, strukturën kualifikuese, gjinore, etnike të shërbyesve civil komunal në administratë, arsim dhe shëndetësisë.

### ■ Zyra e Prokurimit

#### **Raporti i Zyrës së Prokurimit për periudhën Janar - Shtator**

Nr. rend	Emri i projektit	KËRKES VENDIMI	Zotimi i njeteve	Numri i prokurimit	Shifra e prokurimit	Njoftim KRPP-së - APP-së	Njoftim Koutim i qmimeve	Njoftimi për publikim në gazetë	Vlera e ofertës fituese	Kompania fituese
1	Sigurimi I automjeteve të Administratës QKMF-së Shërb.Zjarrfikëse			KA652/10/02/236	65			11.02.2010	7,564.31 €	NSH "PROSING", Kaçanik
2	Furnizim me material stomatologjik dhe laboratorik për QKMF-në. Kaçanik	03.02.'10		KA652/10/03/136	33			02.03.2010	10,000.00 €	NTP "BULI MEDICAL", Prishtinë
3	Furnizim me perde për katin e tretë në objektin e Administratës Komunale	22.02.'10	29.03.'10	KA652/10/04/136	28			08.03.2010	1,736.29 €	NTSH "JETA E RE", Kaçanik
4	Mirëmbajtja dhe riparimi I Automjeteve	03.02.'10		KA652/10/05/236	93			15.03.2010	10,000.00 €	NTP "MELSIA" < Kaçanik
5	Eliminimi I qenëve Endacak	08.02.'10	16.03.'10	8493/10/06/235						Shoqata e gjuetarëve "DRERI", Kaçanik
6	Furnizim me inventar për shkollat dhe Administratën Komunale	12.03.'10	26.02.'10	KA652/10/07/136	20			23.03.2010	5,235.00 €	NTP "METALI", Viti
7	Furnizim me gyp të ujit për pije për shkollën fillorë Ali Asllani paralelja në fshatin Koxhaj	16.02.'10	24.03.'10	KA652/10/08/136	28			25.04.2010	1,836.00 €	NT "NDRIQIMI", Kaçanik
8	Punimi I muralit në shkollën fillorë "Qamil llazi" të fshatit Kaçanik I Vjetër	26.03.'10	29.03.'10	KA652/10/09/236	93			19.03.2010	2,850.74 €	NNSH "P & I", Kaçanik
9	Eliminimi I qenëve Endacak	08.02.'10	16.03.'10	8493/10/06/235						Shoqata e gjuetarëve "DRERI", Kaçanik, është perseritur nga nr rendor 6
10	Meremetimi I Pjesërishëm në disa Shkolla në Komunën e Kaçanikut			KA652/10/12/521	45	01.04.2010		01.04.2010	34,588.00 €	NTSH "P&I" Ferizaj
11	Furnizim me material për mirëmbajtjen e ndërtesës së SHCK-së, Objekteve Shkollore, Shtëpitë e Shëndetit dhe Ndërtesën e Zjarrfikësve	29.03.'10		KA652/10/13/121	31	01.04.2010		01.04.2010	20,000.00 €	NT "Ndriqimi" Kaçanik

12	Vendosja e Bustit të heroit Kombëtar Idriz Seferi në Kaçanik			KA652/10/14/236	93			02.04.2010	5,922.20 €	NP "Consult-Engineering"
13	Asfaltimi I rruges në fshatin Elezaj të Kaçanikut	30.09.'09		KA652/10/15/521	45	13.04.2010		13.04.2010	150,426.70 €	NNT "Eurotrans"
14	Punimi I rrjetit nëntoksor të tensionit të lartë në rrugën Ismail Raka			KA652/10/16/521	45	14.04.2010		14.04.2010	37,714 €	NNTSH "Ar-driti"
16	Ndërtimi I Kanalizimit fekal për Lagjen Imisht në fshatin Lirishtë	30.09.'09		KA652/10/18/521	45	23.04.2010		23.04.2010	23,486 €	"Murseli Company" Shpk
17	Asfaltimi I rruges Lirishtë - Sepetinë	30.09.'09		KA652/10/19/521	45	28.04.2010		28.04.2010	152,077.96 €	"ATC-COM"
18	Rregullimi I murit mbrojtës në lagjen e re-Kaçanik	17.05.'10	18.05.'10	KA652/10/20/525	45	18.05.2010		18.05.2010	9,982 €	NTSH "Ar-driti"
19	Transparenca Komunale për Planifikim Vjetor	13.05.'10		KA652/10/21/521	93	18.05.2010			6,600 €	Radio Kaçaniku
20	Furnizim me material ndërtimor për Shkollën fillorë në fshatin Strazhë	15.09.'09	16.04.'10	KA652/10/22/136	28			20.05.2010	8,483 €	NT "Ndriqimi"
21	Renovimi I objektit të administratës Komunale - Fasadini	26.02.'10		KA652/10/23/236	93			20.05.2010	9,945.00 €	NNTSH "P&I"
22	Furnizim me material higjenik për nevojat e SHCK-së, Shkollat, Zjarrfikësve dhe Shëndetsinë.	13.05.'10		KA652/09/024/136	50			24.05.'10	10,000 €	NTP "Dadini"
23	Furnizim me material ushqimor dhe pije për nevojat e SHCK-së, Shkollat, Zjarrfikësve dhe Shëndetsinë.	13.05.'10		KA652/09/025/136	52			24.05.'10	10,000.00 €	NTP "Dadini"
24	Punimi I rrjetit nëntoksor të tensionit të lartë në rrugën Ismail Raka			KA652/10/26/521	45	14.04.2010		25.05.2010	37,714 €	NTSH "Ar-driti"
26	Sigurimi i objekteve të Administratës Komunale, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Shtëpisë së Kulturës „Xheladin Kurtaj"-Kaçanik. Kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit.	17.05.'10		KA652/10/028/221	93	02.06.2010		02.06.2010	36,000.00 €	NSH "Syri I Shqiponjës"
	"Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për nevojat e SHCK-së, Shëndetsinë, Shkollat dhe Zjarrfikësat", Kontratë njëvjeçare me								150,000 €	NTSH "Shkëndia"

28	Pastrimi i përronjëve në Komunën e Kaçanikut	10.06.'10		KA652/10/030/521	45	21.06.2010		21.06.2010	38,878.56 €	NT"Vlezrit Dema"
29	Ndërtimi i mureve ndarëse në shkollën fillore Oamit Ilazi dhe ndërtimi i WC - ve dhe njëve sanitare në shkollën fillore në fshatin Bicaj	26.05.'10		KA652/10/031/236	93			23.06.2010	9,979.37 € 2,985.00	NTSH"Ar-Driti"
30	Furnizimi me Mobilje për nevojat Administratës Komunale	22.06.'10		KA652/10/032/136	20			25.06.2010		NTP"Metali"
31	Ndërtimi i kanalizimit fekal në rrugën 2 Korriku	28.06.'10		KA652/10/033/521	45	28.06.2010		28.06.2010	39,997.42 €	Murseli Company"Shpk
32	Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në fshatin Doganaj - Lagja Mursel dhe Kolsh			KA652/10/034/521	45	29.06.2010		29.06.2010	34,977.89 €	Murseli Company"Shpk
34	Furnizim me pajisje teknologjike për nevojat e administratës Komunale	22.06.'10		KA652/10/036/136	30			02.06.2010	9,751.00 €	NSH"Elita-IT"
36	Furnizim me lëndë djegëse tërëgjil, për Shkollat	08.07.'10		KA652/10/038/121	10	09.07.2010		09.07.2010	9,120.00 €	NTP"Ajroni"
37	Asfaltimi i rrugës Dëshmorët e Lirisë	30.09.'09		KA652/10/39/521	45	19.07.2010		19.07.2010	39,856 €	NPN"Uniproject"
38	Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës nga maxhistralla për fsh.Biçec dhe fsh.Nikë	30.09.'09		KA652/10/40/521	45	02.08.2010		02.08.2010	47,956.60 €	"Burimi"Shpk
39	Meremetimi i shtëpisë së Kulturës në fshatin Gilboçicë	08.06.'10		KA652/10/41/521	45	03.08.2010		03.08.2010	18,923.55 €	NNP"ATC-COM"
40	Asfaltimi i rrugës Lamaj - Cak - Tifek	30.09.'09		KA652/10/42/521	45	06.08.2010		06.08.2010	90,050.75 €	"Burimi"Shpk
41	Rregullimi i njëve sanitare të personelit, dyshemeve të zyrës së personelit, Drejtorit dhe dritaret e tyre në gjimnazin Skënderbeu	12.08.'10		KA652/10/43/236	93			17.08.2010	8,497.13 €	NP"Consult-Engineering"
42	Sanimi i rrjetit të kanalizimit fekal në lagjen Drogomac dhe lagjen Vathitur	16.08.'10	18.08.'10	KA652/10/44/236	93				6,409.69 €	Shpk"Burimi"

Nr. rend	Emri i projektit	Për periudhën janar shtator 2010							Kompania fituese
		KËRKES	Zotimi i mjeteve	Numri i prokurimit	Shifra e prokuri	Data e kërkesës	Vlera e ofertës fituese		
1	SIGURIMI I PIKAPDS SHENDETSIA	01.02.2010	2136	3136/01/10/147	36	01.02.2010	260.00	KOP DUGAGJINI	
2	SIGURIMI I GOLFI ZYRA EMERGJENTE	01.02.2010			36	01.02.2010	222.00	KOP DUGAGJINI	
3	SIGURIMI I KOMBIT ZYRA KRYETARIT	01.02.2010	2190	2190/03/10/147	36	01.02.2010	222.00	KOP DUGAGJINI	
4	SIGURIMI I GOLFI ZYRA E BUGJETIT	01.02.2010			36	1.02.2010	222.00	KOP DUGAGJINI	
5	SIGURIMI MESTRO DKA	01.02.2010	2959	3236/05/10/147	36	01.02.2010	179.00	KOP DUGAGJINI	
6	RREGULLIMI I AUTOMJETIT QKMF	01.02.2010	2917	2917/06/10/147	28	1.02.2010	115.00	DPT VALON	
7	FURNIZIMI ME MATERJAL TEKNOLOGJIK	28.01.2010	2291	2291/07/10/147	28	11.02.2010	246.00	EMIRI COMPUTERS	
8	FURNIZIMI ME PAISJE TEKNOLOGJIKE QKMF	01.02.2010	2932	2932/08/10/147	28	01.02.2010	760.00	ELITA INFORMATION	
9	FURNIZIMI ME STUFA SHKOLLAT	28.01.2010	577	557/09/10/147	31	11.02.2010	320.00	NT NCFRINI	
10	FURNIZIMI ME PRINTER ZYRA EMERGJENC	03.02.2010	3604	3604/10/10/147	28	03.02.2010	136.00	EMIRI COMPUTERS	
11	SIGURIMI I AUTOMJETIT VIA QKMF	10.02.2010	9121	9121/11/10/147	36	10.02.2010	305.80	KS DUGAGJINI	
12	SIGURIMI I AUTOMJETIT VIA CITROEN QKMF	11.02.2010	9975	9975/12/10/147	36	11.02.2010	276.96	KS DUGAGJINI	
13	FURNIZIMI ME PAISJE TEKNOLOGJIKE SH.FILL.	04.02.2010	4597	4597/13/10/147	28	04.02.2010	683.00	EMIRI COMPUTERS	
14	FURNIZIMI ME LLAPTOP URBANIZMI	18.02.2010	12985	12985/14/10/147	28	18.02.2010	774.00	EMIRI COMPUTERS	
15	FURNIZIMI ME KOPJUTER ADMINISTRATA	26.02.2010	18658	18658/15/10/147	28	26.02.2010	849.00	EMIRI COMPUTERS	
16	FURNIZIMI ME KOMPJUTER A.ASLLANI	11.02.2010	10041	10041/16/10/147	28	11.02.2010	253.00	EMIRI COMPUTERS	
17	FURNIZIMI ME LLAPTOP EMIN DURAKU						649.00	EMIRI COMPUTERS	
18	FURNIZIMI ME LLAPTOP BUJQISIA						737.00	EMIRI COMPUTERS	
19	FURNIZIMI ME PRINTERA URBANIZMI		ESHTË	ANULUAR		OFERTA	0.00		
20	FURNIZIMI ME INVENTAR SHKOLLA	26.02.2010	18754	18754/20/10/147	36	26.02.2010	350.00	NTP GYNI PRISHTIN	
21	FURNIZIMI ME TEPISON QERDHJA	08.02.2010	7141	7141/21/10/147	17	08.02.2010	120.00	SHPTEDONA	
22	FURNIZIMI ME THITHSE ELEKTRIKE	16.03.2010	28572	28572/22/10/147	31	16.03.2010	540.00	IBI/PERFAGSIA KOS	
23	FURNIZIMI ME PAISJE AUTOMJETIT QKMF	29.03.2010	36218	36218/23/10/147	36	29.03.2010	245.00	DPT LONI FERIDA.I	
24	FURNIZIMI ME POLIKOLLOR QERDHJA	1.04.2010	37791	37791/24/10/147	36	1.04.2010	200.00	NTSHJETA E RE	
25	FURNIZIMI ME MAT. HIGJ. SKENDERBEU	12.04.2010	42044	42044/25/10/147	36	14.04.2010	650.00	TE LUTA	
26	FURNIZIMI ME MAT.HIGJ.SKENDERBEU	12.04.2010	42067	42067/26/10/147	36	14.04.2010	850.00	TE LUTA	
27	FURNIZIMI ME LLAPTOP SKENDERBEU	15.04.2010	45787	45787/27/10/147	28	15.04.2010	650.00	EMIRI COMPUTERS	
28	SERVISIMI I RENGENTIT QKMF	15.04.2010	45209	45209/28/10/147	36	15.04.2010	550.00	ELEKTRICISERVISIA PD	
29	FURNIZIMI ME SHTEPIZ KOPJUTERI D.K.A	15.04.2010	45342	45342/29/10/147	36	15.04.2010	258.00	ELITA INFORMATION	
30	FURNIZIMI ME PAISJE SPORTIVE A.ASLLANI	15.04.2010	45356	45356/30/10/147	28	15.04.2010	350.00	FREE SHOP 99	
31	FURNIZIMI ME DRITA SHCK	30.04.2010	56784	56784/31/10/147	28	30.04.2010	983.00	TE SHAGA	
32	SERVISIMI I APARATIT LABORATORIT QKMF	05.05.2010	57987	57987/32/10/147	36	05.05.2010	180.00	NTSHMANI	
33	FURNIZIMI ME PAISJE TEKNOLOGJIKE PROF.		18406	18406/33/10/147	28		198.50	EMIRI COMPUTERS	
34	FURNIZIMI ME MANTILLA PER ARSMTAR	31.05.2010	72359	72359/34/10/147	17	31.05.2010	189.00	SAUKOS	
35	FURNIZIMI ME BATERI PER RADIOLIDHJE	15.03.2010	28057	28057/35/10/147	28	15.03.2010	360.00	IDEA- GUANOV	
36	FURNIZIMI ME PAISJE TË I RRYMES	15.06.2010	79715	79715/36/10/147	28	15.06.2010	943.70	TE SHAGA	

37	FURNIZIMI DHE MONTIMI I PLLAKAVE	20.07.2010	94464	94464/38/10/147	28	20.07.2010	450.00 €	ST.NRCSA FERIZAJ
38	FURNIZIMI DHE MONTIMI I NXEMJES QENDRORE	20.07.2010	94471	94471/39/10/147	28	20.7.2010	500.00 €	PIELEZAJ
39	FURNIZIMI MONTIMI I APARATIT HEMATOLOG	27.07.2010	96883	96883/40/10/147	36	20.07.2010	498.80 €	BULLI MEDICAL
40	FURNIZIMI ME KUBZA BETONI Q.ILAZI	23.07.2010	96333	96333/41/10/147	36	23.07.2010	646.00 €	PIELEZAJ
41	FURNIZIMI DHE MONTIMI I PAISJEVE TE RRYMES	30.07.2010	99723	99723/42/10/147	28	30.07.2010	390.00 €	TE SHALGA
42	FURNIZIMI ME PRINTERA QPS	26.07.2010	96871	96871/43/10/147	28	26.07.2010	294.00 €	ERANIRI COMPUTERS
43	FURNIZIMI ME FOTOKOPJUES N.OSMANI	14.04.2010	43495	43495/44/10/147	28	14.04.2010	450.00 €	ERANIRI COMPUTERS
44	FURNIZIMI ME LAPTOP I.SEDFERI BOB	26.05.2010	70387	70387/45/10/147	28	26.05.2010	650.00 €	ERANIRI COMPUTERS
45	FURNIZIMI ME EKSTRAT SHKUME ZJARRFIKJE	30.07.2010	99967	99967/47/10/147	28	30.07.2010	880.00 €	SHPK TEKNIKI
46	FURNIZIMI ME UNIFOR. VERORE ZJARRFIKSAT	30.07.2010	99974	99974/49/10/147	36	30.07.2010	450.00 €	PRINTEX GJAKOV
47	FURNIZIMI ME UNIFORMA ARSIMTARET E.D	26.07.2010	96898	96898/51/10/147	17	26.07.2010	623.00 €	SANKOSI
48	FURNIZIMI ME PAISJE TEKNOLOGJIKE EMERGJ	02.09.2010	117147	117147/53/10/147	28	02.09.2007	490.00 €	ELITA INFORMATION
49	FURNIZIMI ME PAISJE PER PUNE ZJARRFIKSAT	2.09.2010	117166	117166/54/10/147	28	2.09.2010	240.00 €	STUDIREKLAM NRCSA
50	FURNIZIMI DHE VENDOSJA BARRIERAVE	14.09.2010	122420	122420/58/10/147	28	14.09.2010	290.00 €	DP AKUMULATORI
51	KRYERJA E SHERBIMIT ME SKIP	14.09.2010	122438	122438/59/10/147	28	14.09.2010	315.00 €	LYPETENI MPK
Gjendja deri 30.09.2010							7,166.80 €	
TOTALI JANAR SHTATOR/2010							21,993.76 €	

### ■ Zyra për Teknologji Informative

Zyra për Teknologji Informative ka filluar punët dhe aktivitetet harmonishëm me Planin Vjetor të punës për vitin 2010, konform detyrave dhe përgjegjësi të parapara për vendin e punës.

Zyra për Teknologji Informative (TI) si prioritet kryesor në këtë vit ka qenë e-qeverisja e cila përfshin intranetin, ueb faqja, e-arkiva, e-pasuria etj.

Komuna jonë është në mesin e komunave më të suksesshëm për zhvillimin e këtij projekti, e-qeverisje të cilën e kemi dëshmuar edhe me një grand qeveritar ku si shpërblim kemi marr 7 kompjuterë. Duke u bazuar ne raportet e Konsulentit të TIK-ut nga MAPL, Komuna jone është vlerësuar të jete ndër ato me të suksesshmet, prandaj edhe shpresojmë për grandet tjera që do të pasojnë.

Ueb faqja është duke u pasuruar vazhdimisht me informata të reja, njoftime, raporte, vendime, etj. Ndërkaq e gjithë kjo mirëmbajtje dhe pasurim i të dhënave bëhet nga zyra IT dhe zyra Informimit.

Intraneti është duke funksionuar mjaft mirë, për këtë janë realizuar edhe trajnime të vazhdueshme të personelit me qëllim të implementimit të këtij programi e sidomos në zyrën e pritjes ku të gjitha lëndët futen në intranet të bashkangjitur me dokumente duke përdorur digjital senderin, ku deri më tani janë pranuar 4500 lende të cilat po shqyrtohen nga drejtorit komunale.

E-arkiva në Komunën tonë është shembull për komunat tjera, në bashkëpunim me zyrën e arkivit në mënyrë elektronike kemi arkivuar mbi 2500 lëndë.

E-pasuria, jemi duke i regjistruar të gjithë punëtorët ne këtë aplikacion ne mënyrë që inventari të evidentohet për secilin zyrtarë ne mënyrë elektronike.

Projekti e-qeverisje është duke u aplikuar ne kuadër të programit të Qeverise dhe Strategjisë së Qeverisjes Elektronike 2009 – 2015.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të parapara për vendin e punës gjatë kësaj periudhe kemi mirëmbajt: Kompjuterët ne administrate, serverët të cilat kanë bazën e të dhënave, programin e gjendjes civile, menaxhimin e rrjetit qeveritare, trajnime të vazhdueshme të personelit, mirëmbajtja e programit të gjendjes civile ne teren etj.

Mirëmbajtja e Kompjuterëve trajnime dhe përkrahje të vazhdueshme nëpër Shkolla, Shtëpi Kulturës, QKMF, QPS, Zjarrfikësit ndërsa është bërë edhe monitorimi i kamerave dhe mirëmbajtja e kontrollorit të punës.

### ■ Njësia e Auditimit të Brendshëm

Në bazë Ligjit të Auditimit të Brendshëm Nr. 03/L-128, Neni 14 Pika 2 janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Njesisë së auditimit të brendshëm. Me qëllim të përmbushjes të detyrave dhe përgjegjësiave nga Neni 14, pika 2.7 është përgatitur ky raport nëntëmujor i Auditimit të brendshëm për vitin 2010.

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimin e realizimit të të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm për përudhen janar-shtator 2010.

Me planin vjetor të auditimit të brendshëm, për këtë periudhë kanë qenë të planifikuara të kryhen katër (4) auditime.

Janë kryer tri auditime, ndërsa një auditim është në fazën e punës në teren.

Janë hartuar katër (4) Raporte finale për auditimet e kryera, një raport final është hartuar për auditimin e kryer nga viti paraprak.

Për të gjitha auditivet e kryera e kam dorëzuar Draft Raportet menaxhmentit të njësisë së audituar si dhe raportet finale për auditivet e kryera ia kam dorëzuar menaxhmentit të lartë –Kryetarit.

Me të gjeturat dhe rekomandimet nga auditivet e kryera është pajtuar menaxhmenti i njësisë së audituar, por me shkrim nuk më ka dozuar komentet që të inkorporohen në Reportin final.

Nga të gjitha raportet e auditimit të brendshëm të kryera për këtë periudhë raportuese janë dhënë 11 rekomandime.

Planin për implementimin e rekomandimeve ua kam dorëzuar, por deri me tani nuk kam marrë ndonjë plan për implementimin e tyre. Në fund të vitit do ta bëj një rishikim për implementimin e rekomandimet të dhëna.

Realizimi i aktiviteteve të auditimit të brendshëm, karshi plani vjetor për këtë periudhë është 76.36%.

Gjate kësaj periudhe, pos aktiviteteve të auditimit të brendshëm kam kryer edhe punë tjera administrative, pjesëmarrje në takime dhe trajnime për auditim të brendshëm, hartimin e raporteve vjetore dhe tremujore etj.

- Pjesëmarrja në trajnime në periudhë më të gjatë se ka qenë e planifikuar etj.

### ► Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Edhe gjatë këtij nëntë mujori Administrata Komunale ka vazhduar të jetë mjaft efiçase dhe në shërbim të qytetarëve, duke rritur cilësinë dhe efiçasitetin në lëshimin e dokumentacioneve të gjendjes civile.

Aktivitetet e Drejtorisë janë realizuar përmes skemës organizative e cila përfshihet në 5 sektorë.

Aplikimi i ligjit mbi Librat Amë është përcjell me një angazhim të veçantë në aplikimin e programit të ri për shërbim të gjendjes civile, program i cili kërkon pajisje efiçase kompjuterike dhe angazhim të stafit profesional.



Një angazhim në vazhdimësi është bërë në përcjelljen dhe aplikimin e dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe Kuvendi Komunal, si dhe ofrimi i ndihmës së nevojshme profesionale, sugjerimeve, këshillave dhe udhëzimeve sipas nevojave të parashtruara.

Probleme kyç ka qenë futja e programit të ofiqarisë në zyre të vendit për shkak të rrjetit të internetit ku tash është rregulluar ky problem dhe në zyrat e vendit përveç rregullimit të rrjetit janë rregulluar edhe zyrat janë pajisur me kompjuter të rinj, fotokopjues dhe me kasaforta që janë të domosdoshme për këta zyre dhe po ashtu gjatë këtij viti janë autorizuar të gjithë ofiqarët me Nënshkrime dhe vula personale ku edhe për qytetarët është bërë më i lehtë kryerja e punëve për rregullimin e dokumentacioneve.

Duke u bazuar në raportet statistikore për periudhën Janar – Shtator, del se është rrit dukshëm numri i dokumentacioneve të lëshuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, fakt që tregon përkushtimin e lartë për shërbime ndaj qytetarëve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe hartimi i rregullores për përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunën e Kaçanikut.

### ■ Sektori i Ofiqarisë

Në këtë sektor është pasqyruar puna e shërbimit të Gjendjes Civile për periudhën Janar – Shtator të vitit 2010 edhe atë për zyrat e Gjendjes civile në Kaçanik, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Dubravë, Gilloboçicë dhe Ivajë. Ky shërbim numëron gjithsej 8 punëtor dhe Koordinatorin e shërbimit.

Ky shërbim gjatë periudhës raportuese është angazhuar që në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjeve në fuqi, Rregulloreve dhe Urdhëresave Administrative, Statutit të Komunës si dhe të planit të punës ti kryej obligimet e veta ndaj qytetarëve edhe pse të ballafaquar me vështirësi të ndryshme e veçmas me mungesën e Librave të Gjendjes Civile të cilat regjimi serb gjatë luftës i ka asgjësuar apo bartur për Serbi, si dhe mungesës së dokumentacionit personal i cili është marr me përjashtim të zyrës së Gjendjes Civile në Kaçanik.

Për të arritur qëllimin e kryerjes së dokumenteve për qytetarë në kohë sa më të shkurtër në periudhën Qershor –Gusht të vitit 2010 në bazë të vendimit të komunës është punuar me orar të zgjatur nga ora 08 deri në orën 18 si dhe gjatë ditëve të shtunë.

Në këtë periudhë është punuar edhe në përshkrimin e librave të gjendjes civile edhe atë LAL (Libri Amë i Lindjeve), LAM (Libri Amë i Martesave), LAV (Libri Amë i Martesave) si dhe në rikonstruimin e Librave të cilat janë zhdukur apo asgjësuar gjatë luftës së fundit me qëllim që të përtërihen shënimet e qytetarëve të cilat janë zhdukur. Ky shërbim në zyrat e vendit në teren në këtë periudhë e ka pasur më të lehtë për arsye se të gjitha zyrat e vendit janë pajisur me kompjuter, fotokopjues të rinj të gjitha këto që u cekën edhe më lartë si dhe me autorizimin e nënshkrimeve dhe vulave çdo punë ka qenë më e lehtë si për ofiqarët ashtu edhe për palët.

Në këtë Raport nuk mund të pasqyrohen të gjitha punët sidomos ato të kryera me palë, dhënia e sqarimeve të ndryshme si dhe udhëzimeve të cilat epen edhe për kryerjen e shërbimeve në Ministrinë e Shërbimeve Publike, atë të Punëve të Brendshme, institucionet e statistikave si dhe me zyrat lidhëse të shteteve të përfaqësuara në Kosovë.

Vetëm për Entin e Statistikave pos tabelave apo raporteve për numrin e regjistrimeve janë bërë edhe 894 përshkrime të Raporteve Statistikore, që paraqet një angazhim shtesë i cili merr kohë të konsiderueshme për përgatitjen e tyre.

Vazhdimisht i është kushtuar kujdes punës me palë e sidomos me qytetarët tanë që gjinden përkohësisht në botën e jashtme. Atyre gjithnjë iu është dhënë përparësi në kryerjen e punëve administrative.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer 2637 Vendime, mbi 460 konfirmime, 894 përshkrime statistikore si dhe Raportet e Veçanta të Statistikave me tabela, duke mos llogaritur punët tjera teknike dhe komunikimet me palë si dhe angazhimi i duhur i shërbimit të arkivit komunal në sigurimin e dokumentacionit ku ruhet dhe mbahet pjesa më e madhe e dokumentacionit të arkivuar.

Gjatë vitit 2010 në bazë të Vendimit të KK janë bërë edhe këto përshkrime:

LAL - 1609 përshkrime

LAM - 826 përshkrime.

LAV - 116 përshkrime.

Janë kryer edhe këto rekonstruime:

LAL - 34 rekonstruime

LAM – 99 rekonstruime

LAV – 29 rekonstruime

1. Regjistrimi i lindjeve.....	081
2. Regjistrimi i martesave.....	231
3. Regjistrimi i vdekjeve.....	112

1. Regjistrimi i lindjeve të jashtme.....	374
2. Regjistrimi i martesave të jashtme.....	86
3. Regjistrimi i vdekjeve të jashtme.....	10

## ■ Sektori i arkivit

Sektori Arkivit veprimtarin e vet të punës e mbështet kryesisht në hulumtimin , grumbullimin , përpunimin , klasifikimin , sistematizimin, regjistrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e lëndës arkivore .

Për periudhën kohore janar – shtator 2010 ky sektor ka punuar si në vijim :

Hartimin e planit të punës për vitin 2010

Hartimin e raportit vjetor për vitin 2009

Hulumtimin , grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave përfshirë datën , vitin e lindjes , vendlindjen , datën , vitin dhe vendin e rënies të dëshmorëve të UÇK- së të brigadës 162 “Agim Bajrami “ - Kaçanik .

viktimave civile dhe të zhdukurve , gjithashtu është bërë verifikimi i të dhënave personale në bazë të librave amë të lindjes (LAL ) dhe librave amë të vdekjes (LAV ). Për punën përfundimtare është dashtë të punohet për 3 muaj rresht .

Grumbullimin e fakteve dokumenteve ( Aktgjykimeve , Aktvendimeve dhe shkresave tjera me vlerë ) për ish të burgosurit politik prej vitit 1946 deri 2005. Nga grumbullimi i të dhënave kemi bërë formimin e dosjeve të ish burgosurve politik . Vlen të përmendet se mbi 90 për qind të dokumenteve janë grumbulluar.

Përveç punëve të lartcekura Sektori Arkivit ka punuar në rregullimin, klasifikimin, sistematizimin, regjistrimin dhe valorizimin e lëndëve arkivore të fondeve :

Fondi / 01 – Fabrika e Silkaporit – Kaçanik

– vitet përfshirëse 1961 -1986 ;

Fondi / 06 – Komunikacion dhe lidhje

– vitet përfshirëse 1959 ;

Fondi / 12 – Arsim Shkencë dhe Kulturë

– vitet përfshirëse 1973 ;

Fondi / 13 – Shëndetësi dhe Mbrojtje Sociale

– vitet përfshirëse 1965 – 1986 . Gjithsej : 24 kutia .

■ Pranimin e lëndëve arkivore nga drejtoritë komunale dhe sektorët e tyre

Janë pranuar lëndë arkivore prej vitit 2001 – 2009.

### **Rregullimi i depove**

Përveç sistemimit të lëndëve në bazë të fondeve, nën fondeve, njërive organizative të fondeve dhe viteve janë rregulluar 2 depo me raft të rinj për vendosjen e materialit arkivor

### ■ **Asgjësimi i lëndëve të pavlefshme**

Janë asgjësuar lëndët të pavlefshme, të cilave ju ka kaluar afati si : pushime të lehonisë, shtesa fëmijërore, gazeta zyrtare (dublikate) para vitit 1999 si dhe kërkesa për certifikata të ndryshme si të lindjes, kurorës, vdekjes etj, të cilave ju ka kaluar afati.

### ■ **Arkivimi elektronik**

Sektori Arkivit ka punuar në programin për digjitalizimin dhe arkivimin e lëndëve arkivore në mënyrë elektronike. Deri më tani janë arkivuar **2720** lëndë .

### ■ **Punë me palë**

Për 9 muaj janë parashtruar nga palët dhe drejtorit e ndryshme të K. K. Kaçanik , **87** kërkesa të ndryshme për qasje në dokumente zyrtare. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe në afatin ligjor ju është dhënë përgjigja .

Në mesin e kërkesave kemi pasur nga qytetarët edhe kërkesa për llogaritjen e **stazhit pensionalo-invalidorë**.

### ■ **Zyra e pritjes**

Ne kuadër të drejtorisë së Administratës së Përgjithshme vepron edhe një sektor shumë i rëndësishëm për qytetarët tanë e ai sektor është zyra e pritjes e cila ka shënuar suksese të kënaqshëm duke i ndihmuar e pajisur qytetarët tanë me dokumentacione të ndryshme

dhe duke i dhënë udhëzime te mjaftueshme për çdo lloje informacioni që kërkojnë nga ne, dhe për drejtorit përkatëse.

Në vitin 2010 kemi punuar me orar të zgjatur gjatë pushimeve ngase janë rritur numri i kërkesat të qytetarëve, sidomos të atyre nga bota e jashtme.

Pra në këtë vit është bërë edhe pajisja me kompjuter te ri, digjital skaneri ( futja e dokumenteve ne intranet përmes kësaj pajisje) . Të bashkangjitur keni edhe tabelarin e cili ngërthen informacione detale për lëndët e kryera në vitin 2010.

**Tabelar për lëndët e kryera për periudhën Janar-Shtator-2010**

		JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	Gjithësejt
01.	Çert.të lindjes	952	840	1001	958	1042	1019	1534	1101	1085	<b>9532</b>
02.	Çert.të martesës	696	282	415	327	434	299	410	487	499	<b>3849</b>
03.	Çert.të vdekjes	20	41	41	52	34	49	50	42	36	<b>365</b>
04.	Stat.martesore	59	59	52	42	47	44	50	53	52	<b>458</b>
05.	Dekl.familjare	56	33	53	52	44	50	36	54	64	<b>442</b>
06.	Çert.që është në jetë	25	24	22	28	20	40	83	64	50	<b>356</b>
07.	Çert.të vendbanimit	444	421	395	404	401	464	513	566	386	<b>3994</b>
08.	Çert.të Shtetësisë	551	499	510	550	417	570	618	573	381	<b>4669</b>
09.	Mjete materiale	30	20	12	4	5	3	3	8	5	<b>90</b>
<b>Gjithësejt shuma</b>		<b>2833</b>	<b>2219</b>	<b>2479</b>	<b>2417</b>	<b>2444</b>	<b>2538</b>	<b>3297</b>	<b>2948</b>	<b>2558</b>	<b>23733</b>

		JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	Gjithësejt
01	Regj.të mëv. në LAL	28	07	09	06	12	11	05	06	07	<b>91</b>
02	Regj.të mëv.në LAV	00	03	15	02	07	04	02	05	00	<b>38</b>
03	Përmirësime të emrav	09	07	06	05	05	10	16	14	07	<b>79</b>
<b>Gjithësejt shuma</b>		<b>37</b>	<b>17</b>	<b>30</b>	<b>13</b>	<b>24</b>	<b>25</b>	<b>23</b>	<b>25</b>	<b>14</b>	<b>208</b>

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	Gjithësejt
Kërkesat e SHCK-së	961	825	1307	959	815	780	705	936	712	<b>8000</b>

<b>Gjithsejtë:</b>	<b>3831</b>	<b>3061</b>	<b>3816</b>	<b>3389</b>	<b>3283</b>	<b>3343</b>	<b>4025</b>	<b>3909</b>	<b>3284</b>	<b>31941</b>
--------------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	--------------

## ■ Njësia e Përkthimit

Njësia e përkthimit ka bërë përkthimin e dokumentacioneve nga gjuha serbe në atë shqipe dhe anasjelltas.

Gjatë periudhës, Janar-Shtator-2010 janë përkthyer këto lloj dokumente:

- Përkthimin e lëndëve te ndryshme
- Përkthimin e tenderëve .
- Përkthimin e kontratave.
- Përkthimin e konkurseve te ndryshëm

Përkthimin e Ueb faqes komunale në gjuhen serbe.

Përkthimin e vendimeve te ndryshme te kuvendit komunal dhe përkthimin e te gjithë dokumenteve komunale dhe gjithë këto dokumente janë të ruajtura ne mënyrë elektronike.

#### Sektori Teknik

Sektori teknik përbëhet prej 6 punëtorëve dhe shefit të sektorit.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2010 janë kryer këtë punë teknike si në vijim:

- Mirëmbajtja dhe pastrimin i objektit brenda dhe jashtë.
- Shpërndarjen e postës së jashtme dhe të brendshme.
- Mirëmbajtjen dhe rregullimin e nxehjes qendrore.
- Kujdesin për furnizim me derivate të nxehjes qendrore dhe gjeneratorit dhe
- Riparimet e vogla që ndodhin në objektin komunal etj.

Gjatë vitit ky sektor pos administratës komunale është angazhuar edhe jashtë objektit komunal si në manifestime të ndryshme për rregullimin binës, pastrimin e varrezave të dëshmorëve, vendosjen e flamujve në raste të festave të ndryshme si dhe stolisjen e tërë qyteti me flamuj kombëtarë dhe shtetëror etj.

### ► Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale gjatë periudhës 9 mujore janar – shtator 2010 ka bërë përpjekje te vazhdueshme që të ngritet cilësinë dhe efikasiteti në shërbimet primare shëndetësore , shërbimet sociale dhe shërbimet e inspektimit higjieno - sanitar . Në këtë raport 9 mujor të vitit 2010 janë përmbledhur te gjitha aktivitetet në Drejtorinë e SH.M.S :

#### ■ Shërbimet Shëndetësore

Ne stafin punues të Drejtorisë duke i përfshire edhe QKMF (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare) dhe QPS (Qendra për Punë Sociale) dhe Inspektionin Sanitar, ka hasur ne disa ndryshime te vogla .Gjate kësaj periudhe është zgjedhur drejtori i ri ne QKMF pastaj një punëtor ka dal ne pension të vjetërsisë , një Mjeke dhe Inspektorja sanitare kane lëshuar punën, përveç mjekeve nuk është pranuar asnjë punëtor i ri . Gjate kësaj periudhe është shpallur konkurs nga MSH për pranimin e mjekëve për specializim , ne si komunë kemi konkurruar për 6 specializime ku Ministria e Shëndetësisë ka pranuar 5 kandidat : 2 Mjek të M. Familjare, 1 Gjinekolog, 1 Radiolog dhe 1 Biokimist klinik.

Drejtoria përmes QKMF-së ka bere mbulimin me mjeke te gjitha QMF dhe AF , emergjenca ka funksionuar 24 orë për çdo dit. Edhe këshillimorja për nënat shtatzënë ka funksionuar me rregull edhe pse nuk kemi pasur Gjinekolog , ky sektor është mbuluar nga mamitë e QKMF-së.

Të gjitha shërbimet primare shëndetësore në kuadër të QKMF-së janë kontrolluar nga koordinatori për shërbime primare cilësore ashtu qysh është paraparë me ligjin mbi shëndetësinë.

Furnizimet me barna esenciale gjatë kësaj periudhe 9 mujore kanë qenë shumë të dobëta nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa furnizimet që ka pasur obligim komuna kanë qenë në nivelin më të lartë .

Raporte rreth sëmundjeve ngjitëse dhe kancerogjene të cilat janë dorëzuar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë dega në Ferizaj kanë qenë të rregullta .

Vlen të ceket se drejtorja e SHMS-edhe gjatë këtij 9 mujori ka kryer të gjitha pagesat për shujtën e punëtorëve shëndetësorë në bazë të sugjerimeve të Qeverisë së Kosovës.

Implementimi i Mjekësisë Familjare ka vazhduar në të gjitha QMF-të dhe AF-të në komunën tonë.

Nga fondi i subvencioneve të drejtorisë gjatë këtij 9 mujori u është ndihmuar 27 rasteve për trajtim mjekësor dhe rasteve sociale në vlerë prej 50 deri 200 €.

Aplikacione dhe vërtetime kemi lëshuar për 21 palë , për trajtim mjekësor jashtë vendit të cilat kanë shkuar në Ministrinë e Shëndetësisë për miratim.

Gjithashtu gjatë këtij 9 mujori kemi pasur një donacion nga MSH ,ndërtimin e një QMF ne fshatin Bob në vlerë prej 48000 €,të cilin objekt e ka ndërtuar firma “Termomontimi” nga Prishtina .

#### ■ Shërbimet e kryera në QKMF gjatë 9 mujorit të vitit 2010 kanë qenë si vijon :

Në sektorin e Mjekësisë familjare janë kryer 26.781 shërbime, në sektorin e emergjencës 39.761, në sektorin e stomatologjisë 8.692, në sektorin Pediatrisë 254, në sektorin e lindjes 4, në Shëndetësi Mentale 1.005, Në sektorin e Pulmologjisë 663, në këshillimore të grave 994, në shërbimin e vaksinimit 7.985, në sektorin Laboratorik 5.393, në sektorin e rëntgenit 3.350, në EKG 353, në QMF – Doganaj 1.966, në QMF – Kaçanik të Vjetër 571, në AF – Gilloboqicë 1.708, në AF – Stagovë 1.664, në AF – Biqec 993, në AF – Begracë 1.145, në AF – Dubravë 476, në AF- Kotlinë 1.230 ndërsa në AF – Strazh nuk ka pasur asnjë shërbim për shkak të mungesës të stafit mjekësor .

**Totali i shërbimeve në QKMF .....104.988 shërbime**

#### ■ Shërbimi Social

Gjatë 9 mujorit të këtij viti shërbimet sociale kanë qenë në nivel të duhur , nuk ka pasur asnjë ankesë për mos trajtim të barabartë , të gjithë qytetarëve u është ofruar shërbim i njëjtë dhe me kohë .

Kanë funksionuar dy ekipet :

- **Ekipi i shërbimeve sociale**
- **Ekipi i asistencës sociale**

Ekipi i asistencës sociale - ka përcjell gjendjen e ndihmave sociale. Sipas muajve kemi radhitur shfrytëzuesit e ndihmave sociale dhe atë : Janar 729, Shkurt 743, Mars 735, Prill 739, Maj 741, Qershor 744, Korrik 745, Gusht 744 dhe Shtator 740

Mesatarja 740 shfrytëzues të asistencës sociale

Gjatë këtij 9 mujori janë paraqitur 93 kërkesa të reja prej të cilave 58 janë pranuar ndërsa 35 kërkesa janë refuzuar .

Në komisionin mjekësor janë dërguar 320 lëndë, prej tyre 281 janë pranuar , 8 janë refuzuar dhe 31 lëndë janë në shqyrtim .

Ekipi i shërbimit socialë kujdes të veçantë i ka kushtuar fëmijëve pa kujdesin prindëror , ku numri i tyre ka qenë 23 , prej tyre 12 janë mbështetur materialisht në vlerë prej 75 € në muaj .

**66** fëmijë me aftësi të kufizuar kanë gëzuar mbështetje materiale me vlerë prej 100 € .

Në këtë periudhë 9 mujore nuk kemi pasur keqtrajtim të fëmijëve , prostitucion dhe trafikim nuk ka pasur .

Fëmijët e braktisur në strehim familjar ka qenë një (1 ) rast.

Delikuent të rritur kemi pasur 24 raste të cilëve ju ka shqiptuar masa të shtuara nga ana e prindërve .

Familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta kanë qenë 8 raste ,1 prej tyre është zgjedhur pozitiv , 4 janë këshilluar për plotësimin e dokumentacionit , dhe 3 raste janë refuzuar .

Nuk është evidentuar asnjë rast që ka përdorur substanca psike – aktive, ka pasur 2 ndërmjetësime për bashkimin e familjeve të çrregulluara .

Nuk kemi pasur asnjë rast të strehimit rezidencial .

Të gjitha trajtimet që janë kryer në kuadër të QPS janë të bazuara në Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës .

Edhe në zyrën për shërbime në kuadër të DSHMS janë lëshuar 13 vërtetime të ndryshme Njëkohësisht zyrtari ka qenë i angazhuar edhe në inspektimin e 346 familjeve për ndihma sociale .

### ■ Inspekcioni Sanitar

Të gjitha kërkesat e adresuara pranë inspeksionit sanitar janë shqyrtuar dhe kryer sipas detyrës zyrtare ku :

- 77 kërkesa për inspektorin sanitar dhe 25 kërkesa të kryera bashkërisht me inspektorin e tregut .
- Janë lëshuar vendime për ndalimin e pirjes së duhanit në institucionet publike , si dhe në të gjitha subjektet afariste është ndaluar shitja e duhanit për personat më të rinj se 18 vjeç .
- Komisioni komunal ( sanitar – i tregut ) kanë pranuar teknikisht 55 subjekte afariste , ku pronarët kane aplikuar për leje pune pranë K Kaçanik .
- Inspektori sanitar ka lëshuar 38 pëlqime sanitare për lokacion dhe ndërtim .
- Për mos respektim të kushteve hijeno – sanitare janë shqiptuar gjoba në shumë prej 350 € dhe janë asgjësuar artikuj ushqimor me afat të skaduar me vlerë 250€
- Janë bërë **urdhëresa** për Dezinfektim, Deratizim dhe Dezinfektim për furrat e bukës, restorantet, kafiterit ,gjithashtu është dezinfektuar edhe Çerdhja e Fëmijëve në Kaçanik.
- Në ciklin e parë janë analizuar 22 mostra të ujit të pijshëm .
- Është përcjell dhe raportuar rregullisht mbi gjendjen e ujësjellësit qendror që menaxhohet nga N.K.P“Lypeteni “.
- Janë inspektuar të gjitha objektet edukativo arsimore .
- Gjatë kësaj periudhe është inspektuar tregu i gjelbër

## ► Drejtoria për Arsim e Kulturë

### ■ Sektori i Arsimit

- Inaugurimi i shkollës ne Shtraze e bashke financuar nga Qyteti Sardenia-Itali dhe Komuna e Kaçanikut.
- Sigurimi i transportit për fëmijët e Semajes nga kl V deri ne IX për Elezaj me herët kanë ndjek mësimet ne Gaqkë-Ferizaj.
- Fillimi i projektit me GTZ-Gjermane për trajnimin e arsimtarëve dhe ndërtimi i një kabineti te informatikës ne Sh.f.”Qamil Ilazi” në Kaçanik te Vjetër.
- Organizimi i garave te diturisë për nxënësit e kl.VI,VII dhe VIII ne nivel Komunal dhe pjesëmarrja ne Gara ne Kolegjin “Memet Akif” ne Prishtine dhe pjesëmarrja në garat olimpiada e matematikes.
- Organizimi i një vizite te 8 nxënësve te “Emin Durakut” në Gjermani.
- Mbajtja e ligjëratave në shkolla të mesme për parandalimin e dukurive negative të organizuara nga Drejtoria e arsimit.Temat: Trafikimi i qenieve njerëzore, droga, alkooli, prostitucioni dhe AIDS.
- Projekti me Bankën Botërore - sigurimi i transportit të nxënësve të shkollave të mesme dhe pajisja e shkollave me mjete të konkretizimit.
- Organizimi dhe mbajtja e provimit shtetëror të maturës dhe testit me kl. IX-ta.
- Udhëtimi me nxënësit e shkollës së Sllatinës për Gjermani. Mysafir te krye diplomati gjerman, Ischinger.
- Përgatitja e të gjitha statistikave në arsim dhe raportimi Institucioneve relevante në përfundim te vitit shkollor 2009/10.
- Konkursi për drejtor të shkollave dhe për kuadër arsimor për vitin shkollor 2010/11.

#### ● **Aktivitetet kulturore, rinore e sportive**

Përpilimi i planit të punës për vitin 2010 dhe raporti i punës për vitin 2009

Manifestim kulturor „Flaka e janarit 2010”-shfaqja e dramës „PROCESI”-i autorit Jusuf Gërvalla përmes video-projektorit.

Përgatitje për shënimin e 2 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës si dhe fillimi i turneut memorial në futboll të vogël „Turneu i Pavarësisë”.

Program i jashtëzakonshëm festiv-kulturorë sportiv për përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës, turnir në futboll të vogël, vizitë institucioneve nga një delegacion i të rinjve, parakalim dhe program kulturo artistik për fëmijë, koncert në ambient të hapur me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve „Shota” si dhe është mbajt Akademi Solemne.

Aktivite kulturo artistike me fëmijë me rastin e „Epopesë së UÇK-së, Dita e Mësuesit dhe Dita e Nënës (5,6,7,8-Mars) - homazhe varrezave të dëshmorëve, ndezja e zjarreve, pjesëmarrja e SHKA-„Shqiponja” në manifestimin „Epopeja e UÇK”-së në Prekaz.

Përgatitje organizative për shënimin e Betejës së 9 Prillit 1999, 24 mars - akademi përkujtimore në përvjetorin e masakrës së Kotlinës, me ç’rast u dha edhe një dokumentarë kushtuar kësaj ngjarje përmes video projektorit

Pjesëmarrja e Këshilltarit për Rini e Sport në një takim të nivelit ndërkombëtarë në Turqi, me ç’rast ka përfaqësua Kosovën, ku qëllim kishte parapërgatitjen dhe përpilimin e planit për pjesëmarrjen e 4 të rinjve nga komuna jonë në trajnimin për punë vullnetare me të rinj si dhe shkëmbim përvojash, e në të cilin takim përfaqësuan 6 shtete nga Evropa dhe Azia.

Shënimi i ditës së Pranverës me një program kulturo artistik me fëmijët parashkollor të komunës sonë.



26-28 -mars-me ftesë të OJQ „THE DOOR” dhe bashkia Shkodër, pjesëmarrje me 55 fëmijë dhe të rinj në një festival të lojërave popullore me ç’rast edhe janë zhvilluar edhe dy ndeshje miqësore në futboll për meshkuj dhe femra.

7, 8,9 prill: Festivali i Këngës Popullore për Fëmijë “Kaçaniku 2010”,

Program shënues kulturor për Betejën e 9 Prillit 1999 në Rakoc e Lagje të Re që ka përmbajt program me pika artistike, turne në futboll të vogël dhe Akademi Përkujtimore kushtuar kësaj ngjarje.

Vizitë studimore e Koordinatorit për Rini dhe të Drejtat e Fëmijëve në Koln të Gjermanisë - të cilën vizitë e ka mundësuar organizata qeveritare gjermane GTZ dhe qëllimi i kësaj vizite ishte Forcimi dhe Zhvillimi i Ndhmës për Fëmijë dhe të Rijnë në Kosovë (nga data 11-18 prill)

19-26 prill - pjesëmarrja e 4 të rinjve dhe këshilltarit për rini dhe sport në punëtorinë 7 ditore në Stamboll-Turqi tema e kësaj punëtorie ishte vullnetarizmi tek të rinjtë (shkëmbim përvojash)

Takim i organizatave formale dhe jo formale të komunës sonë me organizatën qeveritare gjermane GTZ me qëllim të nisjes së iniciativës për formimin e Këshillit Rinor Lokal në komunën tonë.

30 prill-shënimi i 100 vjetorit të Betejës së Kaçanikut me këto aktivitete: zbulimi i bustit të Heroit Kombëtarë Idriz Seferi, Simpozium kushtuar kësaj ngjarje, Ekspozitë dhe Akademi Solemne.

Përgatitje për shënimin e 9 Majit - Ditës së Evropës.

Shënimi i 9 Majit - Ditës së Evropës: Vrapim me moton „Drejtë BE”-së si dhe kuizi i diturisë „Të rinjtë dhe Evropa” me çka kanë garuar dy shkollat e mesme të Komunës sonë të cilin aktivitet e ka ndihmuar edhe OJQ „PEN”-nga Prishtina.

Shfaqje teatrale për fëmijë „Mbreti Gjumash” e mbajtur nga Teatri i fëmijëve, dhe të Rinjve nga Prishtina

Debat „Të Rinjtë dhe Ambienti” e organizuar nga Drejtoria për Ambient Pjesëmarrja e SHKA - „Shqiponja” në një festival ndërkombëtarë në Turqi.

Përgatitje për 1 Qershorin-Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Shënimi i 1 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, aktivitete kulturo - artistike për fëmijë si dhe vizitë e një delegacioni të fëmijëve zyrës së Kryetarit.

4 Qershor - nënshkrimi i një Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të DAK-së - sektorit për rini dhe OJQ-së „PEN” nga Prishtina, ku prezent ishte edhe Kryetari i Komunës, Ambasadori i Luksemburgut që është edhe donatore e organizatës „PEN”, përfaqësuesi i UNICEF-it, Drejtori i DAK-së dhe Drejtori i organizatës „PEN”, me që rast solemnisht nga kryetari i komunës u janë dorëzuar çelësat e zyrës të rinjve që do të zhvillojnë aktivitete në kuadër të organizatës.

10-11 qershor: Festivali i SHAKA “Kaçaniku 2010”,

Shënimi i 11 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Kaçanikut, aktivitete kulturo-artistike e sportive (turne në futboll të madh, pjesëmarrës edhe instruktori nga BE- të cilët mbajtën seminar për gjyqtarë futbollit për të gjithë reverët e super ligës së Kosovës në Futboll)

Takim regjional me të rinj në Gjilan, qëllimi: rrjetëzimi i OJQ-ve rinore në regjion si dhe bashkëpunimi në mes tyre, ku nga komuna jonë përfaqësuan 11 të rinj.

Shënimi i Akademisë në 61 vjetorin e rënies së Avdul Durës e Ramë Bekës.

Takim në MKRS –Lansimi i Ligjit të Rinisë për Fuqizim dhe Pjesëmarrje

Ligjërata dhe debate dhe aktivitete sportive me moton Me Sport kundër HIV/AIDS

Koncert me moton mirë se erdhët Mërgimtarë.

Shënimi i 10 Gushtit Ditës së Dëshmorëve të Komunës

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë –aktivitet në pikturë

Shënimi i ditës së Rinisë më 19 Shtator- Aktivitete Kulturo-rinore e sportive

- Ndërkohë, janë organizuar e ndihmuar edhe një varg aktiviteteve e programesh të tjera në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” në Kaçanik, organizuar nga kjo Shtëpi, po edhe mbi bazën e kërkesave të grupeve dhe shoqatave të ndryshme joqeveritare;

- Janë ndjekur edhe një numër i madh seminaresh e punëtorish në komunë e jashtë saj, si në Vushtrri, Prishtinë, Gjilan etj.

## ► Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit

Raportin e punës për periudhën nëntëmuajore të vitit 2010, e fillojmë me një vlerësim të përgjithshëm duke konstatuar se menaxhmenti dhe i gjithë stafi Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, gjatë tërë kësaj periudhe raportuese ka bërë përpjekje dhe përkushtim të vazhdueshëm në drejtim të realizimit sa më të plotë të të gjitha detyrave dhe objektivave të përcaktuara me Programin Operativ të Punës së drejtorisë, për vitin 2010.

*Në vazhdim, shpalojmë punën dhe aktivitetet konkrete të zhvilluara gjatë kësaj periudhe raportuese, më sa vijon:*

■ Zbatimi konsekuent dhe respektimi i afateve ligjore lidhur me procedurat dhe zhvillimin e aktiviteteve në përgatitjen dhe hartimin e dokumenteve buxhetore dhe zhvillimore të komunës, të cilat drafte janë shqyrtuar dhe miratuar në seancat e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2010, si

- Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore për vitin paraprak 2009, me shpalsjen e pasqyrave dhe komentëve, sipas formave dhe tabelarëve shtesë të përpiluara nga ana e drejtorisë;
- Raporti vjetor financiar – Për vitin e përfunduar më 31. dhjetor 2009, i bazuar në Udhëzimin administrativ të MEF-it nr.20/2009. dhe në përputhje të plotë me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik – SNKSP, si material bazë për realizimin e auditimit të rregullt nga Zyra e Auditimit Gjeneral ( ZAGJ-it );
- Përgatitja dhe përpunimi i të dhënave buxhetore për Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK-në ) – Plani i rrjedhjes së parasë për buxhetin 2010 dhe at për zbatimin e Rishikimit buxhetor në muajin korrik 2010;
- Propozim vendimi dhe drafti për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale të vitit 2009, në Buxhetin e komunës për vitin 2010;
- Hartimi i draft - raporteve tremujore mbi realizimin e mjeteve buxhetore për periudhat: Janar-Mars 2010, Janar-Qershor 2010 dhe Janar-Shtator 2010;
- Përgatitja e propozim vendimit dhe draftit për Rishikimin e Buxhetit të komunës, për vitin 2010;

- Përgatitja e propozim vendimit dhe draftit për rregullimet buxhetore në Buxhetin e komunës për vitin 2010;
- Zhvillimi i proceseve dhe të gjitha aktivitetet në përgatitjen dhe hartimin e draft Buxhetit të Komunës për periudhën afatmesëm 2011 – 2013, duke filluar nga Qarkorja e brendshme buxhetore nr.01/2011 – Përgatitja e rishikimit të prioriteteve për buxhetin komunal 2011-2013; Qarkorën buxhetore nr.02/2011- Kufijtë buxhetor specifik për drejtoritë dhe përgatitja e dorëzimeve buxhetore të programeve buxhetore funksionale, për vitet 2011-2013; Përgatitja e draft - Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale – KABK-në për vitet 2011-2013, të cilat dokumente kanë qenë bazë për të gjitha programet buxhetore për inicimin dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve vijuese deri te faza e fundit e nxerrjesë së draft-buxhetit të komunës për periudhën afatmesëm të viteve 2011-2013, i cili draft final është miratuar në Kuvend të Komunës në seancën e 8-të, më datën 24.09.2010;
- Mbajtja e dy (02) dëgjimeve – diskutimeve publike, më datën 21.06.2010 rreth dy rregulloreve komunale dhe më 23.07.2010, me temën: Projektionet dhe politikat zhvillimore të komunës dhe investimet kapitale për vitet 2011-2013 ( dëgjimi i dytë publik i parashikuar për Buxhetin e komunës 2011-13, i përcaktuar për datën 15.09.2010, nuk është mbajtur për shkak të mungesës së kuorumit dhe për mungesë të kohës në përcaktimin e terminit tjetër është shkuarë në alternativ tjetër – shpalosja e Buxhetit të komunës për vitin 2011-2013, nëpërmes të radios lokale );
- Mbajtja e dy (02) takimeve të veçanta për organizimin e orarit të punës së kujdestarive, njërën me 16.08.2010 me pronarët e barnatoreve farmaceutike dhe tjetrën më 22.09.2010, me pronarët e shitoreve ushqimore;
- Përpilimi i propozim Listës së projekteve prioritare për periudhën e viteve 2011-2013, me theks të veçant për vitin 2011. si dhe përpunimi i të dhënave të Projekteve të Investimeve Publike (PIP-at) në sistemin unik në nivel të vendit, i ashtuquajtur – Sistemi i PIP-ave, etj.
- Përgatitja e dy (02) materialeve analitike – Pasqyrat financiare sipas kërkesave të parashtruarë nga këshilltarët komunal: Përlllogaritja e tatimeve dhe kontributeve në pagat e këshilltarëve komunal për tremujorin e parë 2010 dhe për çdo muaj 2010; dhe Pasqyra analitike e ndarjës së subvencioneve dhe transfereve për gjysmëvjetorin e parë të vitit 2010;

■ Në kontekst të harmonizimit të akteve komunale sipas Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale dhe kompletimit të mëtejme të administratës komunale me dispozitat e nevojshme ligjore, janë përgatitur dhe miratuar në organet dhe në Kuvend të Komunës, katër (04) rregullore dhe dy (02) tjera janë në procedura të shqyrtimit dhe miratimit të tyre:

- Rregullorja 01-nr.05-4236/2010. - Për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale, aprovuar më 27.07.2010;

- Rregullorja 01-nr.05-4485/2010 - Për Lejet e pune të Shoqërive Tregtare, e miratuar në Kuvend më 08.06.2010;
  - Rregullorja 01-nr.05-5318/10. - Për përcaktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Kaçanikut, aprovuar më 30.06.2010;
  - Rregullorja 01-nr.05-7491/2010. - Për vendosjen e Tatimit në Pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2011, aprovuar më 24.09.2010;
  - Rregullorja 01-nr.05-7076/10. - Për ndalimin e zënjës së palejuar të hapësirave publike dhe ekspozimit të mallrave jashtë lokaleve afariste, pas shqyrtimit dhe miratimit në Ekzekutivin Komunal më datën 27.08.2010, e njejtja iu është proceduar organeve të Kuvendit për miratim;
  - Rregullorja 01-nr.05-8253/10. - Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës 01-nr.05-5318/10. – Për përcaktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Kaçanikut, i cili draft është në procedurat e procedimit të tij për shqyrtim dhe miratim në organet e Kuvendit;
- Auditimi i rregullt vjetor nga ZAGJ-i për kontrollimin e menaxhimit dhe operimit të komunës me mjetet buxhetore gjatë vitit 2009, i cili proces ka zgjatur nga data 26.04.2010 deri në fund të muajit maj 2010;

Duke marr ndaras rezultatet financiare të DEFZH-së, veçmas nga drejtoritë tjera, theksojmë se në segmentin e inkasimit të të hyrave buxhetore për vitin 2010, planin e sivjetëm të të hyrave buxhetore prej 243,841.- €, për periudhën Janar–Shtator 2010 është arritur që të realizojmë shumën prej 209,199.- €, duke e përmbushur objektivin vjetor për 85,8%, si dhe duke kontribuar në totalin e të hyrave të gjithëmbarshme në nivel të komunës për 52,2% (në raport me periudhën e njejtë nëntëmujore të vitit 2009, kur kjo drejtori kishte arkëtuar shumën prej 172,498.- €, sivjetë kemi trende pozitive të rritjesë për 21,3%). Ndërsa, poçese do t'i dallonim rezultatet e arritura sipas llojit të të hyrave, atëherë lirishtë mund të konstatojmë se te grumbullimi i të ardhurave buxhetore nga Tatimi në Pronë, kemi arritur të realizojmë shumën prej 158,587.- €, që në nivel të totalit të ardhurave komunale të realizuara 2010, paraqet një pjesmarrje strukturale prej 39,6% ( duke filluar nga vitit 2002 dhe përfundimisht me gjendjen e 30.09.2010, nga ky lloj i tatimit komunal kemi arkëtuar gjithësejt 898.769.- €, mjete këto të destinuara vetëm për investime kapitale );

- Mbështetur në punët dhe detyrat e parashikuara me Programin Operativ të Punës së DEFZH-së për vitin 2010, në **Sektorin e Ekonomisë, Zhvillimit dhe të të Hyrave**, janë kryerë këto punë dhe aktivitete,
- Harmonizimi i evidencave dhe rifreskimi i të dhënave të bizneseve për çdo tre muajë duke u bazuar në të dhënat e përpunuara nga Ministria e Tregëtisë dhe Idustriisë (MTI-së) – Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK-ja), pastaj punët e tjera te shërbimet administrative: nga gjithësejt 876 lëndë, janë kryerë 869 sish, kurse në procedurë janë vetëm 7 lëndë; nga këto lëndë të kryera kemi të bëjmë me 743 aktvendime për ngarkesë vjetore nga ushtrimi i bizneseve komunale, lëshimin e 88 çertifikata sipas kërkesave të parashtruara; 23 leje pune të shoqërive tregëtare; 9 kërkesa për zgjatjen e orarit të punës si dhe 6 ankesa ndaj aktvendimeve të drejtorisë, të ushtruara nga bizneset komunale;.
  - Inspektori i Tregut, gjatë kësaj periudhe raportuese në teren ka realizuar kontrollime të rregullta dhe të herëpashershme, duke përpiluar mbi 87

proqesverbale (sidomos angazhimi i tij në njoftimin e bizneseve për rregulloret e reja të miratuara në Kuvend; në zbatimin konsekuent të rregullorës për orarin e punës, në orët e mbrëmjes në shoqërim dhe asistim me policin; përpjekjet e tija permanente në largimin e shitësëve ambulant; kontrollimin e autotransportuesëve në magjistrale; kontrollimi i përbashkët me inspektorët e MTI-së të bastoreve sportive; lëshimi i 37 proqeseve dhe aktvendimeve për pranime teknike të lokaleve të biznesit në bashkëpunim me inspektorët tjerë komunal; 25 proqese për mos vendosjen e orarit të punës në vend të dukshëm; mbylljen e përkohshme të tri (03) lokaleve; ekzekutimin e dy (02) xhobave mandatore; lëshimin e 30 vërejtjeve me shkrim për mos pagesë të ngarkesës vjetore nga biznesi; organizimi dhe mbikçyrja e rregullt për çdo ditë të tregut në dy (02) tregjet: tregun e gjelbërt dhe at të kafshëve etj.;

■ Staf i **Zyrës së Tatimit në Pronë - (ZTP)**, gjatë kësaj periudhe raportuese, punën dhe aktivitetin e saj e kishte të përqendruar në mirëmbajtjen, rifreskimi dhe azhurnimin e të gjitha të dhënave bazë në softuer ; sistemimi dhe përpunimi i të dhënave në mbështetje të formularëve të anketimit për të gjitha objektet e regjistruara ndërtimore për katër (04) zona tatimore të vlerësimit dhe 28 zona katastrale të komunës; përcillja dhe monitorimi i aktivitetit të shpërndarjes së faturave tatimore për vitin 2010, përmes Post-Telekomit të Kosovës ( PTK-ja ka bërë printimin dhe shpërndarjen 7,195 faturave sipas kostos kontraktuese prej 1,647.66 € ); funksionimi i Bordit Komunal të Ankesave, i formuar sipas rregullores dhe vendimit të Kryetarit të komunës 01-nr.4781/10, duke shqyrtuar 79 ankesa, të parashtruara nga taksapaguesit e komunës, e që kanë të bëjnë me faturat e pranuar të vitit 2010 ( pret tyre 78 janë miratuar, kurse vetëm një është refuzuar ); përgatitja dhe lëshimi i 864 vërtetimeve të ndryshme; zbatimi i procedurave të rregullta obligative në kalkulimin e kamatave mujore dhe ndëshkimeve për vonesat në kryerjen e pagesave në softuer, pas skadimit të afatit ligjor - për obligimet e pagesave në këstin e I-rë, dmth. pas afatit ligjor 30.07.2010; bashkëpunimi me MEF-Departamentin e Tatimit në Pronë dhe Agjencionin për Privatizim (AKP-në) në dorëzimin e faturave të pa paguara nga tri (03) ndërmarrjet e privatizuar, etj.

- Në **lëmin e zhvillimit**, duhet posaçërisht të veçojmë bashkëpunimin me Agjencionin për Zhvillimin Ekonomik Regjional – Lindje (AZHR-në ), e themeluar nga Zyra ndërlidhëse e mbështetjes së Bashkësisë Evropiane (BE) për Zhvillimin Ekonomik Regjional në Kosovë dhe Zyrën ndërlidhëse të qeverisë zvicerane – Projekti LOGOS, e që me këtë të fundit më datën 07.09.2010. kemi nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për realizimin e një projekti në fazën e I-rë në shumë deri në 10,000.- € ( Projekti LOGOS do të realizohet në tri faza, ku faza e II dhe III-të do të realizohen gjatë vitit 2011, e që ka të bëjë me shumën e mbështetjes financiare deri në 100,000 € );
- Më datën 28.09.2010, është arritur nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), për themelimin e Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve, i cili projekt do të financohet nga Banka Botërore (BB);

■ Në **Sektorin e Financave dhe Thesarit** , pas trajnimit dhe aftësimit të zyrtarëve financiar, prej datës 09.11.2009, nga MEF-Departamenti i Thesarit na janë deleguar autorizimet dhe kompetencat në ushtrimin e funksionit të procedimit të shpenzimeve në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) dhe përgjegjësia për

ruajtjen e dokumentacionit origjinal, kështu në këtë periudhë raportuese prej datës 01.01.2010 deri më 30.09.2010, sipas kërkesave të parashtruara nga të gjitha programet buxhetore është arritur të zotohen gjithsej 1,066 Urdhëresa për zotim të mjeteve (UZP), prej të cilave në fund të kësaj periudhe raportuese janë ekzekutuar në formë të shpenzimeve masa monetare prej 2.866.100.- €; realizimi i barazimi reciprok për çdo tremujor me të dhënat e evidentuara në librat tona financiare dhe të dhënat e përpunuara finale në Thesar; arkëtimi i drejtpërdrejt i pagesave të gatshme në arkën e Administratës Komunale dhe regjistrimi i tyre në shumë totale prej 62,345.- €; barazimi çdo ditorë i arkës, klasifikimi i arkëtimeve sipas llojeve dhe depozitimi i tyre në bankë ku nga të hyrat vetjake komunale direkt të depozituara në konton e buxhetit të komunës kemi gjithsej 245 ekstrakte bankare; pranimi dhe dorëzimi i Listave të Pagave për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor, të cilat paraprakisht janë përgatitur nga MAP – Departamenti i Pagesave, zbatimi permanent për çdo muaj të ndryshimeve eventuale në listat e pagave sipas aktvendimeve të nxjerrura nga Udhëheqësi i personelit; përgatitja e listave mujore për kompensimin e stafit politik etj.

*Lidhur me detajet e tjera rreth menaxhimit dhe operimit me mjetet buxhetore për vitin 2010 në nivel të komunës, DEFZH-ja ka përgatit Raportin për realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2010, për të cilën do të debatohet veçmas në seancën e radhës gjatë muajit Tetor /2010.*

## ► Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është e organizuar në dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Sektori i Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronësisë.

Duke u bazuar në planin e punës së Drejtorisë dhe në dispozitat ligjore në fuqi, janë kryer të gjitha punët zyrtare, me një angazhim maksimal.

Në raportin vijues janë të përfshira të gjitha kërkesat dhe shkresat e kësaj Drejtorie sipas sektorëve dhe atë:

### ■ Sektori i Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Gjatë periudhës Janar-Shtator në sektorin e urbanizmit janë parashtruar 213 kërkesa nga palët e ndryshme, prej të cilave:

- **119** - janë miratuara,
- **35** - janë refuzuar ,
- **11** - janë shtyrë për vendosje nga ky organ deri në miratimin e Ligjit legalizimeve dhe miratimin e PZHK (Plani Zhvillimor Komunal) ,

- **48** - janë në procedure, për shkak se këto kërkesa lidhen me marrjen e Pëlqimeve nga KEK-u, Drejtori e Rrugëve në Prishtinë, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural etj.

Prej tyre nga ky organ janë lëshuar:

- **30** - Leje Ndërtimore,
- **2** - Pëlqime për hulumtim të resurseve natyrore ( eksploatim i gurit),
- **34** - Vërtetime,
- **12** - Pëlqime për lejim të ndarjes fizikë të parcelave,
- **1** - Aktvendim për ndarje trualli në p.sh. për shfrytëzim të përkohshëm, në K. të Vjetër,
- **2** - Aktvendime për shfrytëzim të përkohshëm të lokaleve pronë e Komunës,

Në këtë periudhë kohore nga DUKMM janë lëshuar :

- **53** - Kontrata për shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale,
- **48** - Urdhëresa për kryerjen e obligimeve –borxheve për shfrytëzimin e pronës komunale,
- **54** - shkresa të ndryshme për Zyrën e Prokurimit, si p.sh. Paramasa të ndryshme, kërkesa për formim Komisioni për pranim teknik, raporte të ndryshme, etj,
- **3** - kërkesa për AKP, për ndalim të privatizimit të disa pronave me interes komunal,
- **26** - Ftesa për palë,
- **4** - kërkesa Zyrës së personelit,
- **3** - kërkesa MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) në Prishtinë për ndihmë lidhur me pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave në Komunën tonë, dhe për miratimin e PZHK-së, sipas procedurave ligjore,
- **1** - Propozim Vendim, për ndarjen e lokaleve pronë e Komunës,
- **21** - Urdhëresa nga Inspektori i Ndërtimtarisë për ndërprerje të punimeve, largim të objekteve të ndryshme,
- **6** - Urdhëresa të ndryshme nga Inspektori Mjedisor, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e Ambientit,
- **4** - kërkesa SHPK-së për asistim në disa aksione të marra nga Inspektori i Ndërtimtarisë, Zyrtari për Tokë ndërtimore.

Kërkesat tjera të parashtruara në këtë Drejtori kanë të bëjnë edhe me :

- ndihmën me mjete materiale për realizimin e disa projekteve të ndryshme nga disa komunitete, të cilat janë shqyrtuar dhe palët janë njoftuar me mundësinë e realizimit të projekteve për fazat gjatë viteve të ardhshme,
- kërkesa nga AKP (Agjencioni Kosovar i Privatizimit) për dhënien e shënimeve të ndryshme për disa prona.

#### ■ **Sektori i Kadastrit**

Gjatë periudhës nëntë mujore në sektorin e kadastrit kemi pasur 4477 lëndë dhe atë:

- Fleta Poseduese

1191

- Kopje Plani	582
- Certifikata	1886
- Ndarje Fizike	86
- Koordinata gjeodezike	312
- Identifikime	55
- Ndryshme	46
- RDPP	319
<b>TOTAL:</b>	<b>4477</b>

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe gjithashtu kemi pasur edhe dorëzimin e materialit kadastral komunës së Hanit të Elezit, ku ky pranim dorëzim është kryer më 30.06.2010 nga ana e Kryetarëve të dy komunave atë të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit. Gjatë muajit Qershor dhe Gusht kemi pasur vizitë nga ana e AKK (Agjencionit Kadastral të Kosovës) ku është marr gjendja e fundit e anës tekstuale për konvertim të shënimeve në Programin e ri softverik KCLIS, ku komuna e jonë është zgjedhur njëra ndër komunat e para pilot për implementim të këtij softveri.

Llojet Dokumenteve										
VITI 2010 Muaji	Fletë poseduese	Kopje Plani	Çertif.	Ndarje fizike	Koordinata Gjeodezike	Identifikim	Pronësia	Ndryshme	Lloji Lëndës RDPP	Totali mujor
Janar	108	82	293	13	31	5	0	4	34	570
Shkurt	135	57	239	3	31	3	0	30	21	519
Mars	312	145	368	5	103	15	0	3	41	992
Prill	154	73	227	18	60	9	0	2	46	589
Maj	89	40	187	12	16	6	0	1	48	399
Qershor	129	83	177	8	9	9	0	4	31	450
<b>Totali</b>	<b>927</b>	<b>480</b>	<b>1491</b>	<b>59</b>	<b>250</b>	<b>47</b>	<b>0</b>	<b>44</b>	<b>221</b>	<b>3519</b>
Korrik	81	30	151	6	12	5	0	0	41	326
Gusht	91	38	94	9	24	2	0	0	31	289
Shtator	92	34	150	12	26	1	0	2	26	343
Tetor										
Nëntor										
Dhjetor										
<b>Totali</b>	<b>264</b>	<b>102</b>	<b>395</b>	<b>27</b>	<b>62</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>98</b>	<b>958</b>
<b>Totali</b>	<b>1191</b>	<b>582</b>	<b>1886</b>	<b>86</b>	<b>312</b>	<b>55</b>	<b>0</b>	<b>46</b>	<b>319</b>	<b>4477</b>



Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe disa trajnime dhe seminare të ndryshme ku vlen të theksohet ai për manipulimin dhe përdorimin me softverin MAPinfo për futjen e të dhënave në azhurnimin e planit zhvillimor hapësinor të komunës dhe pjesës urbane si dhe seminar lidhur me marrëdhëniet me publikun (apo Public Relation) për një qasje më të mirë dhe komunikim më të mirë me palët dhe mediat e ndryshme si dhe vetëdijesimin e palëve për rëndësinë e kadastrit dhe regjistrimin e pronave të tyre.

## ► **Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike**

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të komunës, si dhe në mbështetje të Programit të Punës, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike (DESHP), fushë veprimtarin e sajë, edhe këtë vit, e ka organizuar për mes dy sektorëve :

- Sektorit të Shërbimeve Publike dhe
- Sektorit të Emergjencës(mbrojtja dhe shpëtimi)

### ■ **Spektori i Shërbimeve Publike**

Sa i përket këtij sektori, edhe këtë vit, sipas planit vjetor në fillimin të Janarit, kemi bërë shpalljen publike për rregullimin transportit publik të udhëtarëve në komunën tonë. Pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave, për vija të rregullta me rend të udhëtimit kemi lëshuar: 8 leje pune për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve me autobus, 9 leje pune për kryerjen e transportit publik me kombi dhe 43 leje pune për kryerjen transportit publik me Auto-taksi, të cilët nuk kanë vija të rregullta të udhëtimit. Ndërkaq, në mbështetje të Ligjit për Transportin Rrugor 2004/1, janë refuzuar kërkesat për 3 kombi-taksi dhe një me Autobus.

Edhe gjatë këtij viti, jemi kujdesur për ta përmirësuar infrastrukturën rrugore, përkatësisht në vendosjen e shenjave vertikale në komunikacion. Fillimisht kemi rregulluar shenjat e përparësisë se kalimit në udhëkryqin të Ura e Konakut, pastaj kemi vendosur shenja të kufizimit të shpejtësisë në rrugën Bob - Doganaj, në Lagjen e Dalloshëve, dhe me vonë kemi vendosur edhe 2 shenja të kufizimit të shpejtësisë në rrugën e asfaltuar në K. Vjetër. Gjatë këtij viti, në vazhdimësi kemi bërë inspektimin e transportit publik të udhëtarëve në vijat e rregullta, dhe të atyre që nuk posedojnë leje pune. Njëkohësisht, edhe Stacioni i Autobusëve është inspektuar disa herë nga Inspektori i Komunikacionit, Inspektori i Shërbimeve publike dhe ai sanitar, ku me këtë rast ju kanë shqiptuar masat për përmirësimin e kushteve të këtij stacioni.

Gjatë periudhës nëntë mujore kemi realizuar edhe disa projekt të vogla. Në muajin Prill kemi realizuar projektin për ndërrimin e llambave elektrik të thjeshtë me ato fluroshent në objektin e kuvendit komunal dhe atë të zjarrfikësve, projekt që është kërkuar kushtimisht të realizohet edhe nga Qeveria e Kosove. Kur jemi të ndriçimi duhet theksuar që në muajin Korrik, kemi riparuar ndriçimin publik disa pjesë të qytetit, si: Bulevardi “Ismail Raka”, rruga e “Lagja e Re”, dhe rruga “Skënderbeu”. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, kemi hartuar “Rregulloren për Mbrojtjen e Ambientit”, ku pastaj është miratuar edhe në kuvend.

Ndërkaq, Memorandumi i Mirëkuptimit i arritur edhe këtë vit, në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Zyrës Komonale për Punësim dhe Komunës së Kaçanikut, që ka të bëjë me nxitjen e punësimit përmes projektit të punëve publike, ka filluar më 05.08.2010, me 30 punëtor, ku 15 punëtor janë zgjedhur nga Zyra Komonale e Punësimit, në bashkëpunim me kuvendin komunal, dhe 15 tjerë janë zgjedhur nga kompania e cila ka fituar tenderin. Për dallim nga vitet tjera ky projekt, sivjet do të zgjas 3 muaj. Gjatë kësaj periudhe dy mujore, përmes këtij projekti kemi arritur ti pastrojmë beto përrenj: Lumin Nerodime, pjesërisht lumin Lepec, përrenjtë në lagjen “R.Agushi”, në lagjen e ‘UÇK’-së, në lagjen “Lidhja e Prizrenit”, përroskën e Burnikve, të Berishve, “Rakocit”, dhe përroskën në fshatin Bob.

#### ■ **Mirëmbajta verore dhe dimërore e rrugëve lokale**

Gjatë sezonit dimëror jemi përkujdesur për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të komunës tonë. Për dallim nga vitet tjera kjo çështje është rregulluar për mes tenderit komunal, ku përfitues ka qen kompani N.N “Eurotrans”.

Procesi i mirëmbajtjes verore dhe dimërore përmes kësaj kompanie ka ecur shumë mirë, por duhet theksuar reshjet e mëdha të borës me 9,10 dhe 11 Mars, ku për shkak të gjendjes së rënd nga reshjet e mëdha të borës, kemi angazhuar edhe Ndërmarrjen Komonale Publike “LYPETENI”, për pastrimin e rrugëve nga bora.

Duhet theksuar që me datën 9 dhe 10 Qershor, për nder të 11 Qershorit - Ditës së Çlirimit, kemi angazhuar kompaninë “Eurotrans”, për pastrimin e qytetit. Po ashtu në fillim të këtij viti kemi realizuar një projekt duke shtruar me zhavorr rrugën e fshatit Prushaj, ku në këtë rast janë shtruar 100 m<sup>3</sup> zhavorr.

#### ■ **Shërbimi teknik i mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve, dhe parqeve të qytetit**

Shërbimi teknik i mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve dhe parkut të qytetit, ka kryer punët e për ditshme dhe ato të cilat janë paraqitur sipas nevojës. Është bërë pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e parkut të qytetit dhe sipas nevojës është bërë kositja e barit në park të qytetit dhe në të dy anët e lumit Nerodime, dhe pranë hapësirës së bustit të dëshmorit Ismail Raka dhe bustit të heroit kombëtar, Idriz Seferi”. Nga ky shërbim, por edhe me ndihmën e punëtorëve tjerë, janë mirëmbajtur dhe pastruar varrezat e dëshmorëve, çdo herë një ditë para çdo feste dhe sipas nevojës edhe ditëve tjera. Po ashtu, ky shërbim ka asistuar çdo herë në dekorimin e qytetit për çdo festë.

Vlen të theksohet se ky shërbim ka pastruar Kalanë e qytetit me 7 dhe 8 Qershor, për mbajtjen e festival dhe ditës së çlirimit. Pastrimi i Kalas së qytetit është bërë dhe më 10 Gusht për nder të ditës së dëshmorëve.

#### ■ **Ndërmarrjet Komonale Publike.**

Në komunën ton, qytetarëve ju ofrohet shërbime përmes; Ndërmarrjes publike komunale për mirëmbajtjen e kanalizimit dhe ujësjellësit, NKP ”Lypeteni”, dhe të menaxhimit të mbeturinave përmes Ndërmarrjes Regjionale “Pastërtia”sh.a.

Kur jemi të ndërmarrjet publike, duhet theksuar se pajtim me Ligjin e Ndërmarrjeve Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kemi themeluar Komisionet e Aksionareve dhe Bordet e Drejtorëve të këto ndërmarrje publike.

#### ■ **Njësia për mirëmbajtjen e kanalizimit dhe ujësjellësit, NKP “Lypeteni”**

Gjatë këtij nëntë mujori kjo ndërmarrje ka kryer këto aktivitete:

- Janë kryer 477 intervenime të qytetarët të cilët nuk i përgjigjen shpenzimeve të ujit ,ku prej tyre 39 janë shkyçur nga rrjeti i ujësjellësit,
- Është bërë shkyçja e 17 shfrytëzuesve,
- Janë vendosur 71 ujëmatës,
- Janë dhënë 366 vërejtje të qytetarëve të cilët nuk i përgjigjen pagesave,
- Janë zbuluar 46 kyçje ilegale, ku prej tyre 26 janë legalizuar kurse tjerat janë shkyçur,
- Janë pranuar dhe realizuar 28 kërkesa për marrjen e pëlqimit për kyçje në rrjet,
- Janë eliminuar 163 defekte,
- Është intervenuar ne 36 raste të kanalizimit,
- Është bërë pastrimi i 34 shakteve të ujërave atmosferik,
- Është bërë vendosja e 5 shakteve të ujësjellësit,
- Është bërë pastrimi i 23 ujëmatësve,
- Është bërë bllobimi i 45 ujëmatësve,
- Është vendosur aparatura automatike që bënë 24 ore klorizimin e ujit me Klor dyoksid.

**Shkalla e inkasimit për këtë nëntë mujor ka arrit 79,85%**

#### ■ Njësia për menaxhimin e mbeturinave .

Kjo njësi vazhdon të jetë njësi vartëse e KRM “ Pastërtia “ SH. A. Edhe pse kjo ndërmarrje nuk ka një performancë shumë të mire,krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit ka shënuar një ngritje të lehtë të inkasimit. Në këtë ngritje kanë ndikuar edhe organet komunale duke ndërmarr masa adekuate për personat e pa përgjegjshëm ndaj hedhjes së mbeturinave ne mënyrë të pa kontrolluar.

Mirëpo ende për komunën dhe ndërmarrjen mbesin shqetësim këto probleme:

- Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave duke mos përfillur rregulloren për ambient,
- Mos inkasimi i duhur, hedhja e mbeturinave në mënyrë ilegale në çdo kohë, duke ju shmangur pagesës së tarifave të mbeturinave,
- Mos funksionimi i duhur i deponive regjionale, të cilat menaxhohen nga KLMC-ja etj.

#### ■ Sektori i Emergjencës ( Mbrojtja dhe shpëtimi )

##### ● Rastet më të theksuara emergjente

Me 9, 10 dhe 11 Mars të këtij viti,nga reshje e mëdha të borës kemi pasur situatë emergjente, që për shkak të kësaj gjendje të rënd, jemi detyruar që për pos kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtje verore dhe dimërore, të angazhojmë edhe N.K.P.”Lypeteni” për pastrimin e rrugëve nga bora e madhe. Rasti me serioz dhe më i rëndë është rrëshqitja e tokës dhe shembja e dheut në lagjen “Ramadan Agushi”, ku për këtë problem jeni njoftuar me herët. Kemi pasur edhe raste të djegies së disa shtëpive.

Rastet më të rënda emergjente të cilat janë ndihmuar nga drejtoria jonë: Hazir Jonuzi, me 850 euro, Lagjja e “Ramadan Agushi”, me 1000 euro, Selam Burrniku, me 1000euro, Lulezim Rexhepi, me 500 euro, Fadil Axhami, me 200 euro, Mustaf Mani, me 500 euro, Metush Palloshi, me250 euro.

#### ■ Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit

Ky shërbim ka qenë 24 orë në gjendje gatishmërie për qytetarët e komunës tonë. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje të lehtë të zjarreve, të cilët konkretisht kanë qenë zjarre malor, dhe shërbimi i zjarrfikësve në ato vende ku është paraqit nevoja ka

Intervenimet e SHZSH në Kaçanik sipas muajve dhe sipas llojit të intervenimit për janar -shtator 2010

Lloji i objektit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Shtëpi-objekte banimi	2	2	4		1								9
Male dhe zjarre hapura			2	6		1	5	20	7				41
Objekte ndihmese						1		1	2				4
Kontejner, depo mbeturinave	1		2	2	4	1		2					12
Objekte afariste biznesi		1											1
Objekte shtetërore-institucione													
Stalla - pleme								1					1
Ushqim i kafshëve							1	1					2
Intervenime teknike	2	1	4				4		3				14
Trafo elektrike-shtyla			1	1									2
Zjarre ne automjete	1	1		1	1	1	1		1				7
Tjera intervenime, shërbime						2			3				5
<b>Gjithsejte</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>25</b>	<b>16</b>				<b>98</b>

reaguar me sukses.

## ► Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari

Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari (DBZHRP) për periudhën janar-shtator 2010, aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e synimeve dhe objektivave të cilat ia ka parashtruar vetes në programin e punës për këtë periudhë raportuese.

Drejtoria e bujqësisë ka zhvilluar aktivitetin e vetë në këto sektorë: sektorin e lavërtarisë, blegtorisë, pemëtarisë, prej muajit korrik edhe në sektorin e pylltarisë, duke u bazuar në kompetencat dhe detyrat e përcaktuara me Statut të Kuvendit të Komunës, ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Një angazhim i veçantë gjatë kësaj periudhe ishte në drejtim të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe me shoqatat (OJQ-ët) vendore dhe ndërkombëtare.

Bashkëpunimi ka qenë kryesisht në aspektin ofrimit të bashkëpunimit në implementimet e projekteve për subvencionim të fermerëve (projekti i subvencionimit në pemëtarë, kafshëve të imëta, lopëve qumështore dhe mëshqerrave). Të gjithë fermerët i kemi udhëzuar për plotësimin e aplikacioneve dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim në subvencionet e ofruara nga MBPZHR, me qëllim që fermerët tanë të jenë sa më të kompletuar në dokumentacionin e kërkuar.

Nga projektet për subvencionim të lopëve qumështore dhe mëshqerrave kanë përfituar 82 fermerë, në vlerë prej 22.680 € ndërsa për kafshë të imëta kanë përfituar 31 fermerë në vlerë prej 31080 €. Sa i përket sektorit të pemëtarisë subvencionimi ende nuk është bërë edhe pse kemi fermerë tanë që kanë aplikuar e që projekti i është pranuar.

Kemi bashkëpunuar me OJQ-ën vendore Haiffer - Kosova dhe kemi aplikuar në projektin e mëshqerrave. Projekti është realizuar dhe kap shumën 55.500 €, në projekt ka participuar edhe Kuvendi Komunal me shumë prej 15.500€. Shpërndarja e 22 korrëve është bërë në fshatin Dubravë dhe Doganaj. Gjithashtu kemi bashkëpunuar edhe me OJQ-ën KS-Kosova përmes Qendrës së Biznesit lidhur me ofrimin e ndihmës në mbështetje të fermerëve dhe subjekteve afariste prodhuese me linja kreditore, me kamata të volitshme (5%) me qëllim zhvillimit të bizneseve në komunën tonë. Të gjithë aplikuesëve për linja kreditore u kemi ofruar ndihmë në plotësimin e planit të biznesit dhe kompletimin e dokumentacioneve të kërkuara. Deri më tani nga ky projekti OJQ-ës KS-Kosova përmes bashkëpunimit me zyrën e Qendrës për përkrahjen lokale të Bizneseve, nga linja kreditore kanë përfituar fermerë e subjekte afariste prodhuese (10) në vlerë prej 71.000 €.

Në fillim të muajit prill me kërkesë të qytetarëve të adresuara në emër të drejtorisë kemi organizuar aksionin katër ditor për eliminimin e qenve endacak. Në projekt janë përfshirë të gjithë fshatrat dhe qendra e qytetit, gjatë zhvillimit të aksionit janë asgjësuar 243 qenë endacak.

Kjo drejtori ka qenë i angazhuar edhe në hartimin e projekteve ideore siç janë: Projekti për prodhimtarinë e perimeve në fushë të hapur (katër fusha provuese me kultivimin e domates dhe specit) projekti veç është realizuar me mjete nga buxheti komunal (vlera e projektit 840 €) projekt propozimi për stimulimin e fermerëve me grurë për sipërfaqet prej 0.5-1.5 ha, projekti për stimulimin e fermerëve me fidanë të pemëve (projekte që janë në fazën përfundimtare për aplikim të fermerëve), projektin për bletari, projekti për ngritjen e 10 serrave me sipërfaqe prej 250 m<sup>2</sup>, projektit për organizimin e panairit të gjedhit. si dhe plotësimi i projekteve ekzistuese.

Vlen të theksohet projekti për panairin e gjedhit “Kaçaniku 2010” u realizua me përkrahjen Buxheti Komunal, dhe OJQ-ës KS-Kosova (janë shpërblyer 20 fermerë).

Kjo drejtori gjatë vitit raportues ka qenë i angazhuar edhe në projektet të cilat implementohen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të financuara nga Bashkësia Evropiane, siç është projekti i shërbimeve këshillimore për fermerë, ku fermerëve vazhdimisht i është ofruar këshilla në aspektin profesional dhe ofruar material trajnues) si dhe ofrimin e të dhënave sipas kërkesës së Ministrisë Bujqësisë, për planin operativ të mbjelljeve pranverore, vjeshtore si dhe për realizimin e mbjelljeve dhe informata tjera sipas kërkesës së Ministrisë.

Gjithashtu gjatë këtij viti kemi pasur një bashkëpunim të mirë me MBPZHR lidhur me njoftimin e fermerëve për subvencione për lëmit e ndryshme të bujqësisë. Të gjitha aplikacionet për subvencione janë plotësuar në zyrat e DBZHRP, ku fermerëve u kemi ofruar ndihmë rreth kompletimit të dokumentacionit të kërkuar nga MBPZHR dhe te njëjtat janë dërguar në zyrat Regjionale të Ministrisë Bujqësisë në Gjilan.

Gjatë këtij viti nga MBPZHR fermerët e Komunës sonë prej projekteve për subvencionim( projektit për lopë qumështore, projekti për mëshqerra, projekti i kafshëve të imëta ( deleve dhe dhive), kanë përfituar 113 fermerë.

Me përkrahjen e OJQ-së KS-Kosova është organizuar edhe trajnimi me kombajnerë, me qëllim të eliminimit të humbjeve në kokërr gjatë fushatës së korrje-shirjeve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe përcjellja e mbjelljeve pranverore, vjeshtore si dhe e fushatës së korrje-shirjeve. Ne si drejtori kemi qenë të obliguar të përcjellim fushatën e korrje-shirjeve, duke kontrolluar kombajnerët rreth cilësisë së korrje-shirjeve ku për

secilin kombajnerë është mbajtur evidencë për sipërfaqet e korrura me qëllim të raportimit në MBPZHR, lidhur me rendimentin e grurit për ha. dhe shfrytëzimit të subvencioneve të ofruar nga MBPZHR për kombajnerë (20 lit. naftë /ha. të korrur), me qëllim që çmimi i korrjeve të jetë më i volitshëm për fermerë. Gjithashtu janë bërë edhe inspektime: në ruajtjen e tokës bujqësore,

Janë shqyrtuar 40 lëndë për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, prej të cilave 26 lëndë janë miratuar dhe ju kanë dërguar aktvendimet për pagesë, 4 prej tyre janë refuzuar, 4 janë dërguar në MBPZHR, dy lëndë janë në shqyrtim dhe 6 kërkesa janë të pezulluara për arsye të mos plotësimit me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore deri në periudhën e fundit të muajit shtator janë vjel mjete në shumë prej 8669 €.

Përveç organizimit të trajnimeve, seminareve të ndryshëm me fermerë kjo drejtori ka qenë e hapur për dhënien e këshillave profesionale për të gjithë ata të cilët kanë kërkuar një ndihmë të tillë, edhe fermerëve individual.

Është punuar në fazën përfundimtare PZHK (Plani Zhvillimor Komunal) dhe PZHU (Plani Zhvillimor Urban) ku i janë dhënë vërejtjet për përmirësime të cilat vërejtje i janë përcjellë kompanisë "Data Gis" e cila është e angazhuar në hartimin e planit Zhvillimor dhe Urban të komunës sonë.

### ■ Sektori i pylltarisë

Për këtë sektor mundë të ofrojmë të dhëna pas kalimit të kompetencave nga APK-ja prej muajit korrik. Me bartjen e kompetencave është bërë një riorganizim i ri në kuadër të drejtorisë për bujqësi, fillimisht është bërë plotësimi i stafit të punëtorëve në zyre dhe me rojet e pyllit. Sa i përket këtij sektori gjendja në mbrojtjen e pyjeve para kalimit të kompetencave ka qenë jo e mirë, andaj duke e parë të nevojës që urgjentisht duhet një planë veprimi për mbrojtjen e pyjeve, drejtori i drejtorisë bashkë me stafin e sektorit të pylltarisë dhe me asistencën e policisë kanë marrë masa shtesë për tejkalimin e kësaj gjendje, me qëllim të vënies nën kontroll të prerjeve ilegale të pyjeve nga prerësit ilegal. Për pengimin e kësaj dukurie negative kanë ndikuar asistimet e shpeshta gjatë ditës dhe natës, duke ju ofruar ndihmë rojeve të pyllit. Tani është arrit që gjendja të jetë nën kontroll. Kësaj i ka ndihmuar edhe vendosja e një pike kontrolli 24 orësh në njësinë "Ahishta", ku është vendosë një barrierë për pengimin e hyrje daljeve pa leje.

Me qëllim të pengimit të prerjeve ilegale dhe për hir lehtësimi të qytetarëve për furnizim me dru zjarri, me propozimin e Drejtorisë së BZHRP Kuvendi komunal duke marrë për bazë propozimin e drejtorisë ka marrë Vendim për aplikimin e tarifave për pagesën e mbeturinave .

Prej bartjes së kompetencave në kuadër të drejtorisë janë zhvilluar këto aktivitete siç vijon:

Tenderimi i ngastrave nr.16, 21, 24, 33, 35 për prerjen e masës drusore prej 3810.62 m<sup>3</sup>, prej tyre dru teknik 1576,32 m<sup>3</sup> dhe 2234,30 m<sup>3</sup> dru zjarri. Gjatë Ankandit publikë kanë ofertuar pesë operatorë ekonomik, katër prej tyre janë licencuar për shfrytëzimin e kësaj mase drusore të cilëve tani i është bërë pranim dorëzimi i ngastrave ku kanë filluar punën të gjithë operatorët ekonomik.

Prej bartjes së kompetencave nga APK-ja në kuadër tërë të drejtorisë janë konfiskuar 97.93 m<sup>3</sup> apo shprehur në metër hapësinor 143 m.

Numri i fletëparaqitjeve të dërguara në Gjykata për periudhën korrik, gusht dhe shtator janë 150 fletëparaqitje për kundërvajtje, transport ilegal dhe vepër penale.

Sa i përket pyjeve private edhe pse me vonesë është filluar në shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga qytetarët, është arrit që 90% e kërkesave të shqyrtohen. Është bërë shënjimi i drunjëve të prerë në të gjitha lokacionet, sasia e drunjëve të shënuar në ballë është 1.139.40 m<sup>3</sup>.

Fletë dërgesa të dhëna 130 .

Të hyrat nga taksat në shërbime për pyje private janë 2208.44 €.

Mjete të dorëzuara nga pagesa për mbeturina për muajin shtator kapë shumën 770 €.

Kryetari i Komunës

---

z.Xhabir Zharku